



PRIORITETET E 2014-ës



Gjeneralmajor Jeronim Bazo, vizitë pune në komandën e FT

Objekt i kësaj vizite pune ishte vlerësimi i përgatitjes fizike të efektiveve dhe të stërvitjes, si elementi bazë i performancës së një force të armatosur

faqe 2

KOMISIONI PËR POLITIKËN E JASHTME

Ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, seancë dëgjimore për Ukrainën

faqe 3

BASHKËPUNIMI

SHSHPFA, gjeneralmajor Jeronim Bazo priti atasheun ushtarak kanadez

Atasheu ushtarak kanadez, garanton mbi vijimësinë e programeve të trajnimit në Kanada

faqe 2

CEREMONIA



Në Ministrinë e Mbrojtjes kremtohet 8 marsi, "Dita Ndërkombëtare e Gruas"

Ministrja Kodheli: Do të punoj fort për dërgimin e parë të një ushtareje profesionale në operacione luftarake

faqe 6

MBLIDHET KËSHILLI I SIGURISË KOMBËTARE

Shqipëria në prag të Strategjisë së re të Sigurisë Kombëtare

10 vjet që nga koha e hartimit të dokumentit të fundit të Sigurisë Kombëtare, merret nisma për Strategjinë e re



faqen 4-5

Ministrja Kodheli flet për Dokumentet Strategjike dhe zhvillimin e Forcave të Armatosura

"Do të kemi një Forcë më të strukturuar, më të vogël dhe më profesionale"

Intervista e ministres së Mbrojtjes, në lidhje me mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, Dokumentin e Strategjisë Ushtarake dhe 'Planin e Zhvillimit Afatgjatë' të FA



Kontigjenti "Eagle - 8"

faqen 3

BASHKËBISEDIMI I KRYEMINISTRIT RAMA NË PROMOVIMIN E LIBRIT "HESHTJE E DYFISHTË", TË GAZETARIT CARLO BOLLINO

"Heshtje e dyfishtë", e vërteta për armët kimike në Shqipëri



I konceptuar, në mënyrë krejt të veçantë nga gazetari, - si një bashkëbisedim, me pyetje dhe përgjigje, - ky promovim bëri protagonistë kryesore politikanë të lartë të vendit, mes të cilëve Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë Ilir Meta, Ministri i Jashtëm Ditmir Bushati dhe Ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli. Së bashku me kryeministrin Rama...

faqe 8-9

INSPEKTIMI/ GRUP-DEPOT

Gati operacioni i dy certifikimeve të reja nga Brigada Logjistike

faqe 7

FORCA DETARE

Intensifikohet standardizimi sipas STANAG/Ap-ve të NATO-s

faqe 11

FTESE PËR DEBAT

Në kërkim të modelit të arsimimit

faqe 12-13

AFA



KLO, perfeksionon procesin e vendimmarrjes ushtarake

Përfundon me sukses me "Kursin e Lartë të Oficerit", stërvitja "Veleçiku 2014"

faqe 7

Objekt i kësaj vizite pune ishte vlerësimi i përgatitjes fizike të efektivëve dhe të stërvitjes, si elementi bazë i performancës së një force të armatosur

Gjeneralmajor Jeronim Bazo, vizitë pune në komandën e FT

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, ka zhvilluar paraditen e datës 10 mars 2014, një vizitë pune në Komandën e Forcës Tokësore. Në këtë takim gjeneral Bazo është prituri nga komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, si dhe komandantët e reparteve të varësisë. Objekt i kësaj vizite pune ishte vlerësimi i përgatitjes fizike të efektivëve dhe të stërvitjes, si elementi bazë i performancës së një force të armatosur. Gjeneral Bazo, duke u ndalur në prioritetet e punës së FA për vitin 2014, theksoi se stërvitja duhet të jetë kryefjala e të gjithë reparteve të Forcave të Armatosura, si në veprimtarinë ditore, ashtu edhe në kuadër të angazhimeve jashtë vendit. “Stërvituni më shumë dhe më mirë, me qëllim që të kemi sa më pak të papritura”, nënvizoi ndër të tjera gjeneral Bazo. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Jeronim Bazo, gjatë këtij takimi ka falënderuar nga afër drejtuesit e njësisë të varësisë të Forcës Tokësore, për angazhimin e tyre në operacionin e pastrimit të territorit të Shqipërisë.



Atasheu ushtarak kanadez, garanton mbi vijimësinë e programeve të trajnimit në Kanada



SHSHPFA, gjeneralmajor Jeronim Bazo priti atasheun ushtarak kanadez

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, ka prituri në datë 12 mars 2014, në një takim kortezie atasheun ushtarak kanadez, kolonel Spike Hazleton. SHSHPFA, gjeneralmajor Jeronim Bazo ka vlerësuar nivelin aktual të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve tona në fushën e mbrojtjes, duke veçuar bashkëpunimin në programet e gjuhës angleze dhe trajnimet që janë zhvilluar. Gjeneral Bazo më tej e ka njohur me procesin e reformimit të Forcave të Armatosura shqiptare si dhe me përmbushjen e detyrimeve që Shqipëria ka ndaj NATO. Nga ana e tij, atasheu ushtarak kanadez, kolonel Spike Hazleton, e garantoi shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, për vijimin e programeve trajnuese për Forcat e Armatosura shqiptare në Kanada. Gjeneral Bazo dhe kolonel Hazleton shprehën gatishmërinë dhe mbështetjen për vendimmarrjen për çështjen e Ukrainës.



Zhvillohet konferenca planëzuese ndërministrorë në përgjigje të fatkeqësive natyrore

Është zhvilluar në datë 11 mars 2014, në ambientet e auditorit të Ministrisë së Mbrojtjes konferenca fillestare planëzuese gjithëpërfshirëse ndërministrorë në përgjigje të fatkeqësive natyrore. Stërvitja zhvillohet në kuadër të bashkëpunimit të Ministrisë së Mbrojtjes (QBO dhe QS) dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile) dhe ka për qëllim intensifikimin dhe unifikimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe procedurave të përbashkëta ndërmjet këtyre institucioneve në përgjigje të fatkeqësive natyrore kombëtare dhe rajonale. Në këtë konferencë merrnin pjesë gjithashtu përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministria e Mjedisit, Ministria e Financave, etj.

OPINION

Pse një Forcë e Armatosur e Kosovës?

Nga Zaim Kuçi

Një vend që pretendon të gëzojëtribute të plota shtetërore e të njohura ndërkombëtarisht; që përfaqëson një popullsi gati 2 milionëshe, domethënë e krahasueshme me të gjitha shtetet simetrike, që shtrihet në një rajon ende të trazuar në pikëpamje të sigurisë dhe stabilitetit ku prania dhe kujdestaria e forcave të atashuara nga komuniteti ndërkombëtar ka e do të ketë një limit kohor, një vend i tillë pra, do të duhet, krejt normalisht dhe e justifikuar ligjërisht si në pikëpamje të vullnetit të brendshëm, ashtu edhe në pikëpamje të ligjshmërisë ndërkombëtare, ka të drejtën jo thjeshtë të sigurohet, por edhe të mbrohet. Kosova ka tashmë një mandat pothuajse përfundimtar “de fakto” për të ushtruar të gjitha atributet e njohura ndërkombëtarisht të një shteti. Mbi 100 e ca vende e kanë njohur. E rëndësishme është që ka njohjen e shteteve të “bërthamës” së Evropës, e atyre shteteve që janë lokomotiva e saj si edhe të SHBA. Nga ana tjetër, nuk mund të mos harrojmë se pothuajse të gjitha shtetet e krijuara nga shpërbërja e Ish Jugosllavisë i dhanë të



drejtën vetes dhe po kështu komuniteti ndërkombëtar iu dha të drejtë jo vetëm të formësonin shtetet e reja, por edhe forcat respektive të armatosura. Kështu, historia nuk ka pasur një Republikë të pavarur të Maqedonisë dhe ky shtet i ri u krijua vetëm dy dekada më parë. Por me të drejtë ky shtet e ka tashmë forcën e vet të armatosur dhe ky fakt nuk përbën problem pasigurie në rajon, por përkundrazi, përbën një faktor sigurie e bashkëpunimi. Po kështu, Mali i Zi e ka një forcë të armatosur të vetën prej rreth 2,094 ushtarë në

shërbim aktiv. Po kështu, ushtria serbe e ka një forcë të armatosur prej rreth 33.000 ushtarësh aktivë. Me limite të tilla kapacitetesh njerëzore, këto forca, të çdo vendi qofshin, përbëjnë vetëm një referencë mbrojtjeje e sigurie dhe asnjëherë një referencë rreziku e kërcënimi për të tjerët. Pa kapacitete të tilla, të mjaftueshme në numër, në armatime dhe pajisje, ato nuk mund të kryejnë dot detyrat e detyrimet për ruajtjen e pavarësisë dhe integritetit territorial, nuk mund të mbështetin dot kushtet që mundësojnë stabilitet ekonomik, konsolidimin

e shtetit demokratik si dhe sigurinë e stabilitetin rajonal. Në këto kushte, qeveria e Kosovës, ka vendosur të transformojë Forcën e Sigurisë së Kosovës në një Forcë të armatosur të rregullt. Natyrisht që ky transformim do të përfshijë misionin, strukturat dhe detyrat. Misioni do të jetë ai që normalisht shpallin të gjitha vendet me forcë të armatosur, domethënë “për të mbrojtur sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës, popullit të saj dhe pronën e tyre dhe mbrojtjen e interesave të Republikës së Kosovës.” Ndërsa Forca aktuale e Sigurisë së Kosovës ka afërsisht 2,500 ushtarë aktivë të armatosur lehtë dhe 800 rezervistë, Forca e ardhshme e Armatosur e Kosovës pritet të përbëhet nga rreth 5,000 ushtarë aktivë dhe 3,000 rezervistë. Ky transformim si në numër, edhe në cilësi e misionet planifikohet të përfundojë në vitin 2019. Sigurisht që këto synime e objektiva do të arrihen brenda një plani afatmesëm, ndoshta pesëvjeçar, me qëllim që alokimet e nevojshme financiare të jenë në përshtatje me fuqinë ekonomike të shtetit, me mbështetjen e organizmave ndërkombëtare si NATO e BE, si dhe me gjendjen e sigurisë në rajon e më gjerë.

STAFI

Kryeredaktor:
Albert HITOALIAJ

Gazetarë:
Alba MUSARAJ

Redaktore korrektore:
Elona SHIMAJ MAKO

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ

Intervistë e ministres së Mbrojtjes Mimi Kodheli

Ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli, në datën 11 mars 2014 dha një intervistë për "Top Channel", në lidhje me mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, Dokumentin e Strategjisë Ushtarake dhe Planin e Zhvillimit Afatgjatë të Forcave të Armatosura. Më poshtë sillen çështjet e diskutuara në këtë intervistë të shkurtër.

Znj. Kodheli një koment tuajin si ministre e Mbrojtjes në lidhje me Strategjinë dhe në lidhje me mbledhjen e sotme të Këshillit të Sigurisë Kombëtare?

Më lejoni t'ju them fillimisht që mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare është një organ këshillimor pranë presidentit, ndërkohë që në programin qeverisës në 300 ditët tona të para janë mirëpërcaktuar afatet e bërjes të së gjithë dokumenteve strategjike, duke filluar që nga dokumenti i Sigurisë Kombëtare, tek Dokumenti i Strategjisë Ushtarake dhe Plani i Zhvillimit Afatgjatë të Forcave të Armatosura, të gjitha brenda këtij viti. Ka qenë shumë e rëndësishme që ne ta shtyjme këtë proces, i cili për fat të keq ishte vjetruar tashmë siç edhe ju e përmendët në insertin tuaj. Kishte 10 vjet që FA dhe Ministria e Mbrojtjes funksiononin me një strategji të vjetruar dhe aq më pak një strategji e cila nuk kishte reflektuar ngjarje të rëndësishme që kishin ndodhur në jetën politike dhe jo vetëm të Shqipërisë, siç ishin, anëtarësimi i Shqipërisë në NATO në vitin 2009.

Shihet qartë dhe flitet gjithashtu edhe në media dhe qarqet politike për përplasje mes presidentit dhe qeverisë së re në shumë fusha. A mund të thuhet e njëjta gjë edhe për sa i përket bashkëpunimit tuaj si ministre e Mbrojtjes me presidentin

Ministrja Kodheli flet për Dokumentet Strategjike dhe zhvillimin afatgjatë të FA



"Ne duhet të kemi një forcë e cila do të jetë më e strukturuar, do të jetë më e vogël në numër, por më profesionale, do të jetë më e mirë-pajisur dhe e gatshme për t'ju përgjigjur qoftë detyrave të saj kushtetuese apo ligjore, siç është mbrojtja e integritetit të Shqipërisë apo mbrojtja dhe siguria e qytetarëve të saj, por pse jo mbrojtja e sigurisë në rajon edhe më gjerë, pjesëmarrja në të gjitha operacionet e NATO, të cilat ne na kërkohen dhe jo domosdoshmërisht ne u jemi përgjigjur ashtu siç duhet në vitet e shkuara".

e Republikës?

Mua më vjen mirë që në atë tryezë sot u kërkua bashkëpunim dhe bashkërendim institucional, por jo domosdoshmërisht ata që e kërkuan këtë janë

ata të parët të cilët e kanë zbatuar këtë. Fakti që ky Këshill nuk është mbledhur që prej shumë kohësh, madje është mbledhur 3 herë në 10-vjeçarën e fundit tregon për mungesën e bashkërendimit

dhe bashkëpunimit midis institucioneve kur forca tjetër politike ishte në qeverisje. Kjo në fakt nuk na e ka kufizuar këndvështrimin tonë dhe hapjen tonë drejt Institucionit të Presidentit dhe të gjithë institucioneve të tjera, të cilat duhet të jenë bashkëpunuese dhe bashkërenduese dhe suportive të asaj ç'ka qeveria shqiptare ka ndërmend dhe do të bëjë. Fakti që me urdhër të kryeministrit në fillim të muajit shkurt u ngrit grupi ndër-institucional për hartimin e Strategjisë, por jo vetëm kaq, por fakti që ne kemi çuar pranë presidentit strukturën e FA dhe Planin e Përhapjes ose

Planin e Vendosijes së FA dhe prej më shumë se sa një muaj nuk kemi marrë përgjigje megjithëse jemi rikthyer disa herë kërkesave edhe të panevojshme teknike nga Institucioni i Presidentit na bëjnë të besojmë që kjo është një procedurë e cila kërkon të pengohet nga ana e Institucionit të Presidentit, i cili në rastin më të mirë është vetëm miratues i asaj çka Ministria e Mbrojtjes dhe kryeministri propozojnë pranë Institucionit të Presidentit.

Si e shpjegoni ju që prej 5 vjetësh pas anëtarësimit në NATO nuk kemi pasur një strategji të re dhe asnjë mbledhje të Këshillit të Sigurisë Kombëtare?

Kjo është një pyetje që duhet t'ia bëni në fakt personave të cilët kanë drejtuar më parë këtë institucion, qoftë qeverisjes së mëparshme, qoftë presidentit të mëparshëm. E rëndësishme është që sot ne të ndajmë dy gjëra. E para, që qeveria është shumë e fokusuar për ta çuar deri në fund këtë proces sepse jemi në një vit deçiziv, të rëndësishëm të NATO, duke pasur parasysh që në fillim të shtatorit të këtij viti do të jetë samiti, një ndër samitet më të rëndësishme për të ardhmen, jo vetëm të NATO, por edhe të gjithë proceseve gjeopolitike në tërësi, por edhe atë çka ne duhet të bëjmë me strukturat e FA nesër. Ne duhet të kemi një forcë e cila do të jetë më e strukturuar, do të jetë më e vogël në numër, por më profesionale, do të jetë më e mirë-pajisur dhe e gatshme për t'ju përgjigjur qoftë detyrave të saj kushtetuese apo ligjore, siç është mbrojtja e integritetit të Shqipërisë apo mbrojtja dhe siguria e qytetarëve të saj, por pse jo mbrojtja e sigurisë në rajon edhe më gjerë, pjesëmarrja në të gjitha operacionet e NATO, të cilat ne na kërkohen dhe jo domosdoshmërisht ne u jemi përgjigjur ashtu siç duhet në vitet e shkuara.

KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Miratohet projektligji i bashkëpunimit ushtarak financiar, ndërmjet Shqipërisë dhe Turqisë

Komisioni për Sigurinë Kombëtare miratoi projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ushtarak financiar, ndërmjet Shqipërisë dhe Turqisë dhe të Protokollit të zbatimit të Ndhmës financiare". Komisioni për Sigurinë Kombëtare shqyrtoi projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ushtarak financiar, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe të Protokollit të zbatimit të Ndhmës financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë". Të pranishëm në mbledhje ishin specialistë nga Ministria e Mbrojtjes, por Kryetari i Komisionit, z. Spartak Braho kërkoi që të ketë përfaqësim politik nga ministria e linjës në rangun e ministrit apo zv/ministrit sa herë që të shqyrtohet një marrëveshje apo projektligj. Anëtarët e komisionit ranë dakord që t'i drejtohen me një shkresë Ministrisë së Mbrojtjes për çështjen e nivelit të përfaqësimit në komision dhe vazhduan me shqyrtimin e marrëveshjes. Pas diskutimeve, komisioni miratoi në parim dhe nen për nen projektligjin. Më tej, Komisioni i Sigurisë Kombëtare vijoi me debate lidhur me seancën dëgjimore me kryetarin e Shërbimit Informativ Shtetëror, z. Visho Ajazi. Seanca e planifikuar për 5 mars u shty për shkak se z. Ajazi nuk ishte i pajisur me certifikatën e sigurisë, e domosdoshme në rastet e raportimit të 'sekreteve shtetërore'.

Kodheli, seancë dëgjimore për Ukrainën

Komisioni për Politikën e Jashtme zhvilloi në 7 mars, 2014 një seancë dëgjimore me ministren e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli, lidhur me situatën e krijuar në Ukrainë. Kryetarja e komisionit, Arta Dade u shpreh se situata e krijuar në Ukrainë ka tërhequr vëmendjen e të gjithë organizimeve euroatlantike ku Shqipëria bën pjesë, si edhe ato globale që nga Kombet e Bashkuara, NATO, OSBE, KE, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, BE. Sakaq tha znj. Dade, Shqipëria dhe të gjithë faktorët politik janë të unifikuar në qëndrimet e tyre lidhur me situatën në Ukrainë. Në fjalën e saj përpara komisionit ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli ka theksuar se zhvillimet e fundit në Ukrainë janë në vëmendjen e qeverisë dhe se qeveria shqiptare i ka dënuar ndërhyrjet me forca ushtarake të Rusisë në Ukrainë. "Ndërhyrje në kundërshtim të hapur me normat e së Drejtës Ndërkombëtare dhe në shkelje

Misioni i OSBE-së në Krime

Deklaratë për shtyp e Ministrisë së Mbrojtjes

E diel, 09 mars 2014. Dëshirojmë të informojmë opinionin publik se Shqipëria ka vendosur të kontribuojë me dy vëzhgues në misionin e OSBE-së në Krime. Me kërkesë të Ukrainës, dhe në zbatim të Kapitullit III të Dokumentit të Vjenës për Besimin Reciprok dhe Ndërtimin e Masave të Sigurisë, ky mision përbëhet nga më shumë se 25 vende anëtare të OSBE-së ku përfshihen SHBA, vende Evropiane dhe përfaqësues të Qendrës së Parandalimit të Konflikeve të OSBE-së. Ky mision vëzhgimi bazohet në një nga mekanizmat më të rëndësishëm të OSBE-së për ndërtimin e mirëbesimit, dhe përfshin inspektime dhe misione vëzhguese në territorin e një vendi anëtar të organizatës që ka forca të armatosura.

të sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit", shtoi znj. Kodheli. Në vijim, ministrja e Mbrojtjes nënvizoi se Shqipëria mbështet integritetin territorial të

Ukrainës, gjithashtu mbështet të drejtën e popullit të Ukrainës për të përcaktuar të ardhmen e tij, pa ndërhyrjen nga jashtë.

Burimi: parlament.al

Mblidhet Këshilli i Sigurisë Kombëtare

Shqipëria në prag të Strategjisë së re të Sigurisë Kombëtare

Dhjetë vjet që nga koha e hartimit të dokumentit të fundit të Sigurisë Kombëtare, Presidenti i Republikës, Bujar Nishani, mori nismën e fillimit të punës së hartimit të Strategjisë së re duke thirrur në datën 11 mars 2014 në tryezë, drejtuesit më të lartë të institucioneve. Në takimin e zhvilluar me presidentin, merrnin pjesë kryeministri Edi Rama, ministri i Jashtëm Ditmir Bushati, ministri i Punëve të Brendshme Saimir Tahiri, ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, ministri i Financave Shkëlqim Cani, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, Edmond Haxhinasto, Kryetari i Kuvendit, Ilir Meta dhe në krah të kryeparlamentarit, - ndonëse nuk është anëtar, por ishte ftuar, lideri i opozitës, Lulzim Basha, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, kreu i Shërbimit Informativ Shtetëror, Visho Ajazi, krerët e Komisioneve të Sigurisë e Integritetit etj. Ky takim në tryezën e Presidentit të Republikës, shënon edhe fillimin e punës së institucioneve të vendit për një Strategji të re të Sigurisë Kombëtare. E kërkuar nga qeveria Rama sapo mori detyrën dhe për të cilën në 2 dhjetor të vitit të shkuar me urdhër të Kryeministrit u ngrit grupi i punës, Strategjia e Sigurisë Kombëtare, do të përfshijë: "Mirëfunksionimin e Forcave të Armatosura, ruajtjen e rendit, Shërbimin Informativ, masat për ruajtjen nga terrorizmi, luftën kundër trafikëve të paligjshme dhe krimin të organizuar, ruajtjen e kufijve të vendit, paprekshmërinë tokësore dhe detare, kujdesin për ekonominë në tërësi si dhe kujdesin për ruajtjen e burimeve energjetike, biznesve strategjike, monedhës, shëndetit të shtetasve etj", - deklaroi Presidenti i Republikës, Bujar Nishani. Strategjia e re Sigurisë pritet të përfundojë në fund të muajit maj. Ajo do të konsultohet nga ekspertë të fushës dhe shoqërisë civile. Projekt-dokumenti do t'i paraqitet Këshillit të Ministrave, Kuvendit dhe Këshillit të Sigurisë Kombëtare dhe miratimi pritet të bëhet jo më vonë se korriku i 2014-ës. Ky afat i paraprind samitit të NATO-s në Uells, Britani, në shtator të këtij viti, ku vendi ynë do të mund të paraqesë një dokument të ri, i cili do të tregojë panoramën e sigurisë së brendshme për t'iu përgjigjur detyrimeve të anëtarësimit tonë në NATO. Më poshtë jepet fjala e plotë e Presidentit Nishani.

Institucioni i Presidentit të Republikës informon se, bazuar në pikën 3 të nenit 168 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 11; 12 dhe 13 të ligjit 8671, datë 26.10.2000, azhurnuar me ligjin Nr. 9194, datë 19.2.2004 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës



së Shqipërisë", Presidenti i Republikës SH.T.Z. Bujar Nishani, ka zhvilluar në datën 11 Mars 2014, mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare (KSK). Në fjalën e hapjes, Presidenti Nishani u shpreh:

"Zoti Kryetar i Kuvendit, Zoti Kryeministër, Zotërinj anëtarë të Këshillit të Sigurisë Kombëtare, Të nderuar të ftuar! Ju falenderoj për pjesëmarrjen! Ju falenderoj për frymën e mirëkuptimit dhe angazhimin në përgatitjen e këtij takimi!

Siç edhe jeni në dijeni, në këtë mbledhje janë programuar dy çështje; - Puna e bërë për përgatitjen e dokumentit të ri të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë, procesi i përgatitjes së kësaj Strategjie, metodologjia e përdorur, aktorët dhe faktorët që do ta mundësojnë, afatet e formulimit. Për këtë do të na raportojë ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati.

- Zhvillimi i reformës bazuar në Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes 2013, plani i zbatimit, paketa ligjore, çështja e ristrukturimit të Forcave të Armatosura, menaxhimi i problemeve sociale të reformës. Për këtë do referojë ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli.

Para se t'ua jap fjalën Ministrave, në cilësinë e Kryetarit të këtij Këshilli, dy fjalë për Ju të nderuar pjesëmarrës, bashkëpunëtorët për çështjet e Sigurisë Kombëtare, si dhe për qytetarët shqiptarë në përgjithësi:

Siguria Kombëtare është një koncept tepër i gjerë. Siguri Kombëtare është gjithçka që kontribuon pozitivisht në mbrothësinë e kombit. Si e tillë, "Siguri Kombëtare", janë edhe elementë të jetës shoqërore, politike, kulturore, siç janë mirëedukimi, mirëshkollimi, sjellja qytetare, ndërgjegjia komunitare, zbatimi me korrektësi i Ligjit, marrëdhëniet normale shumicë-opozitë, mirëfunksionimi dhe bashkërendimi i punëve ndërinstucionale dhe të tjera.

Siguria Kombëtare e përcaktuar dhe e institucionalizuar si e tillë, ajo për të cilën jemi këtu, pra ajo që ka një Këshill dhe për të cilën ndërtohet një Strategji, përfshin elementë të përcaktuar qartë, siç janë mirëfunksionimi i Forcave të Armatosura, të ruajtjes së Rendit, të Shërbimit Informativ, masat për ruajtjen nga terrorizmi, lufta kundër trafikëve të paligjshme dhe krimin të organizuar, ruajtja e kufijve të vendit, paprekshmëria tokësore dhe detare, kujdesi për ekonominë në përgjithësi, si dhe kujdesi për ruajtjen e burimeve energjetike, biznesve strategjike, monedhën, shëndetin e shtetasve, dhe të tjera.

Për ta bërë sa më të plotë dhe gjithëpërfshirës bashkëpunimin në çështjet e Sigurisë Kombëtare të kuptuar si më sipër, në këtë mbledhje të sotme që nuk ka lidhje me ndonjë rrezik akut, por me procesin e hartimit të një dokumenti që do të shtrijë efektet e tij për dekada të ardhshme, dhe një dokument që do të orientojë reformat më të rëndësishme të këtij vendi, në funksion të zgjerimit të audiencës tradicionale, kam ftuar edhe kryetarin e opozitës, Lulzim Basha. E falenderoj me këtë rast zotin Basha, dhe i them se e mirëpres kontributin e tij në çështjet e Sigurisë Kombëtare!

Me këtë rast, ju siguroj se si President i Republikës dhe Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura do të jem gjithë kohën i vendosur për të ushtruar me përkushtim maksimal autoritetin që më jep Kushtetuta dhe Ligji në fushën e Sigurisë Kombëtare!

Në vazhdim të kësaj vendosmërie, si Kryetar i Këshillit të Sigurisë Kombëtare, duke lutur njëkohësisht edhe mirëkuptimin dhe angazhimin Tuaj, me qëllimin për ta shndërruar këtë Këshill në një mekanizëm aktiv, po përgatis një program vjetor të punës së këtij Këshilli.

Sa u përket çështjeve në diskutim në takimin e sotëm, ju lus të bëjmë ç'është e

mundur të ndajmë këndvështrime sa më të përafërta lidhur me gjendjen aktuale, arritjet, problematikat, sfidat, dhe, çfarë është kryesorja, përafrimin e sistemit tonë të sigurisë me atë të vendeve të tjera të NATO-s dhe BE-së.

Përgatitja dhe miratimi i paketës ligjore të dokumenteve strategjike deri në Samitin e NATO-s që do mbahet në fillim të shtatorit në Uells të Mbretërisë së Bashkuar, do jetë një rast i mirë të provojmë se jemi anëtarë seriozë të Aleancës, dimë të punojmë dhe të bashkëpunojmë, dimë të mirëkuptohemi."

Pas fjalës së hapjes së Presidentit Nishani, referuan ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati për çështjen e parë si edhe më pas ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli për çështjen e dytë.

Më pas në diskutimet e hapura u shpreh kreu i opozitës, Lulzim Basha si edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Jeronim Bazo.

Në fjalën e mbajtur në mbyllje të kësaj mbledhjeje, presidenti i Republikës, SH.T.Z. Bujar Nishani vlerësoi se:

"Për sa i përket "Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë:

Fillimisht, përgëzoj të gjitha strukturat dhe personelin e angazhuar për punën e bërë në përgatitjen e këtij dokumentin e Sigurisë së Republikës së Shqipërisë! Falënderoj zotin Bushati për panoramën e qartë që paraqiti në këtë takim!

Pa asnjë mëdyshje, dokumenti i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare (SSK) është dokumenti themelor strategjik në fushën e sigurisë kombëtare të RSH-së. Në këtë kontekst, më lejoni të shpreh disa konsiderata të miat për këtë dokument, i cili ndryshe nga dokumentet paraardhës, do të formatizojë 'de jure' modelin e sigurisë sonë kombëtare në kuadrin e sigurisë kolektive të Aleancës së Atlantikut të Veriut.

Gjykoj që SSK 2014 duhet të iniciojë dhe adresojë reforma të gjithëpranuara në institucionet e Sektorit të Sigurisë së vendit tonë, në përputhje me stadin e ri të vendit Aleat, stadi të kandidatit potencial në BE, dhe mjedisin e ri të sigurisë kombëtare, rajonale dhe globale. Kjo do të thotë që SSK 2014 të jetë një strategji përtej qeverisë me një përfshirje sa më të gjerë politike për të qenë një dokument i gjithë-pranuar për tu zbatuar me sukses në planin afatgjatë. Fatmirësisht, gjatë 22 viteve të fundit vërejmë shumë qëndrime konverguese të klasës politike shqiptare për çështje themelore të sigurisë kombëtare, të cilat menjëherë duhet të reflektohen me cilësi më të lartë në këtë dokument të ri.

Vlerësoj se, SSK 2014 duhet të reflektojë shqetësimet e gjithë shoqërisë shqiptare dhe grupeve të interesit për sigurinë kombëtare, duke pasur një



Strategjia e re Sigurisë pritet të përfundojë në fund të muajit maj. Ajo do të konsultohet nga ekspertë të fushës dhe shoqërisë civile. Projekt-dokumenti do t'i paraqitet Këshillit të Ministrave, Kuvendit dhe Këshillit të Sigurisë Kombëtare dhe miratimi pritet të bëhet jo më vonë se korriku i 2014-ës. Ky afat i paraprind samitit të NATO-s në Uells, Britani, në shtator të këtij viti, ku vendi ynë do të mund të paraqesë një dokument të ri, i cili do të tregojë panoramën e sigurisë së brendshme për t'iu përgjigjur detyrimeve të anëtarësimit tonë në NATO.

përfshirje sa më të gjerë me përfaqësues nga shoqëria civile, grupe të interesit, komuniteti i biznesit, organizata jo-qeveritare e institute 'think tank' apo akademike, etj, si dhe përfaqësues të interesave mbarë-shqiptare.

Konsideroj që, sipas praktikave moderne, në formulimin e kësaj SSK 2014 mund të përfshihen edhe partnerë strategjikë të vendit tonë. Për këtë qëllim, në disa faza të procesit mund të përfshihen në procesin e formulimit të SSK edhe përfaqësues nga partnerët strategjikë të vendit tonë, si nga struktura të specializuara të NATO, BE, SHBA, Kosova e ndonjë vendi tjetër. Po ashtu mund të merret mendimi i organizmave të specializuara në këtë fushë si Qendra "Marshall", Kolegji i NATO-s në Romë, apo Instituti i Studimeve Strategjike të BE-së, etj.

Një çështje tjetër shumë e rëndësishme është ndërtimi i një platformë komunikimi dhe angazhim aktiv sa më efektiv me publikun gjatë gjithë procesit të formulimit të SSK 2014. Këtij qëllimi mund t'i shërbejë hapja e një



website për shkëmbime aktive online të gjithë ekspertëve dhe qytetarëve sipas eksperiencës më të mirë të Konceptit Strategjik të NATO-s dhe vendeve anëtare të saj. Ky website mund të hapet në faqen e Ministrisë së Jashtme, si drejtuese e procesit. Po ashtu, sipas fazave dhe çështjeve themelore të dokumentit, mund të ftohet media e shkruar dhe vizive për një debat të hapur publik, e cila do të ndihmojë në prodhimin e një dokumenti të shëndetshëm.

Gjithashtu, SSK 2014 duhet të prodhojë reforma që synojnë një siguri të matshme dhe të prekshme për qytetarët dhe shtetin shqiptar. Për këtë qëllim, SSK-2014 duhet të shoqërohet me një Plan Veprimi me masa për të gjitha institucionet e shtetit, afatet e zbatimit të tyre, si dhe resurset përkatëse. Kjo metodologji do të ofrojë një siguri më të matshme për objektivat që ajo synon, si dhe do të prodhojë një siguri më të prekshme për qytetarët dhe shtetin shqiptar.

Për sa i përket “Reformës së Mbrojtjes”:

Fillimisht, përgëzoj stafin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm për përkushtimin e dedikuar në programin e reformës së mbrojtjes, si dhe falënderoj zonjën Kodheli për informacionin e plotë që na ofroi për këtë çështje.

Në gjykimin tim vëmendje kryesore duhet t'i kushtohet zhvillimit të kapaciteteve prioritare për përmbushjen e misionit të FASH. Jam në një mendje me Ministren Kodheli, që në kushtet e resurseve të kufizuara financiare, prioritet kryesor t'i kushtohet si ngritjes së kapaciteteve të certifikuar/të matshme që rrjedhin nga anëtarësimi në Aleancë (Paketës së Objektivave të Kapaciteteve me NATO-n), por edhe kapaciteteve për mbështetjen e popullit shqiptar në emergjencat civile dhe misione të tjera specifike.

Vlerësoj veçanërisht që, Programi i Qeverisë 2013-2017 dhe Direktiva e Mbrojtjes 2014 konfirmojnë vullnetin për të adresuar gjetjet dhe rekomandimet e dokumentit të Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes (RSM-2013) si referencë bazë e vijimësisë së reformave të mbrojtjes. Po ashtu, konstatoj me kënaqësi që ka vetëdije dhe vullnet nga të gjithë aktorët kryesorë në fushën e sigurisë për përshtetimin, përgatitjen, konsultimin dhe miratimin e kuadrit ligjor dhe të dokumenteve strategjike të vendit.

Në këtë atmosferë të favorshme, më lejoni që si President, Kryetar i Këshillit të Sigurisë Kombëtare, dhe si Komandant Përgjithshëm i FASH të ndaj me ju disa vlerësime, që në gjykimin tim kanë impakt të konsiderueshëm në procesin e reformave të mbrojtjes së vendit tonë, si vend Aleat i NATO-s:

Së pari, vlerësoj që reformat e

mbrojtjes duhet të paraprihen dhe mbështeten me ndryshimet përkatëse ligjore. Pavarësisht dëshirës së mirë që mund të kemi, reformat e mbrojtjes duhet të bazohen në ligj; pra reformat duhet të fillojnë pas ndryshimeve ligjore dhe jo e kundërta. Ndryshimet ligjore duhet të reflektojnë me kujdes çështje themelore të konceptit të ri të mbrojtjes së vendit në kuadrin e mbrojtjes kolektive, në ligjet në fuqi si Ligji mbi Autoritetet e Komandimit Kontrollit Strategjik, Ligji mbi Strategjinë Ushtarake, Ligji për Statusin e Ushtarake, Ligji për Gradat dhe Karrierën, Ligji për Agjencinë e Inteligjencës së Mbrojtjes, etj.

Së dyti, mendoj se duhet të arrihet një mbështetje më e gjerë politike dhe publike për reformat e mbrojtjes. Është shumë rëndësishme që këto ndryshime ligjore të kenë mbështetjen e spektrit politik, në mënyrë që reformat të zba-

tohen me sukses në planin afatgjatë. Po ashtu, edhe diskutimi dhe mbështetja publike duhet të shikohet si një element i rëndësishëm. Rëndësi e veçantë t'i kushtohet gjithashtu përfshirjes dhe marrjes së mendimit të personelit drejtues të FASH, si dhe angazhimit të qendrave të specializuara akademike dhe kërkimore për çështje të mbrojtjes, etj.

Së treti, vlerësoj se krahas përpjekjeve për formulimin e Strategjisë së Sigurisë së RSH-së, duhet të përgatiten edhe dy dokumentet strategjike të reformës së mbrojtjes: Strategjia Ushtarake dhe Plani Afatgjatë i Zhvillimit (PAZH). Këto dokumente mund të zhvillohen sipas nivelit të hierarkisë së tyre nga lart poshtë (pra në fillim SSK, pastaj SU, pastaj PAZH), ose me grupe pune paralele duke shkëmbyer informacion në kohë reale.

Së katërti, në gjykimin tim vëmendje kryesore duhet t'i kushtohet zhvillimit të kapaciteteve prioritare për përmbushjen e misionit të FASH. Jam në një mendje me Ministren Kodheli, që në kushtet e resurseve të kufizuara financiare, prioritet kryesor t'i kushtohet si ngritjes së kapaciteteve të certifikuar/të matshme që rrjedhin nga anëtarësimi në Aleancë (Paketës së Objektivave të Kapaciteteve me NATO-n), por edhe kapaciteteve për mbështetjen e popullit shqiptar në emergjencat civile dhe misione të tjera specifike.

Së pesti, edhe unë mendoj se duhet të rishikohet struktura e Forcave të Armatosura bazuar në konceptin e ri të mbrojtjes strategjike të vendit të bazuar në Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes RSM-2013. Vlerësoj punën e bërë nga Ministria e Mbrojtjes dhe inkurajoj që të krijojmë në bashku një kulturë të re të bashkëpunimit intensiv në procesin e vendimmarrjeve strategjike në fushën e mbrojtjes. Nga ana tjetër, gjykoj që struktura e re e FASH të mos konsiderohet vetëm si një shkurtim numrash për të kaluar në 8500 vetë në vitin 2015, por në radhë të parë ajo duhet të adresojë organizimin më të përshtatshëm të kapaciteteve operacionale të nevojshme për përmbushjen më cilësore të misionit të FASH. Ndryshimet sasiore duhet të shoqërohen me cilësi operacionale nëpërmjet zhvillimit me krijimtari të koncepteve të reja për një “smart defence” rajonal, zbatimit me efektivitet të konceptit të veprimit në formatin “joint”, “ndërminterial” dhe “ndër-aleat”, përmirësimit të komandimit kontrollit strategjik dhe operacionale, dhe aty ku është e mundur, futjes së konceptit të forcës modulare, të organizimit të forcës për detyrën “task force”, të zhvillimit të kapaciteteve të specializuara “niche”, të konsiderimit të sistemit “roster” të përdorimit të personelit aktiv që del në rezervë, etj.

Së gjashti, vlerësoj se modernizimit të forcës duhet t'i jepet një vëmendje e veçantë në strukturën e re të FASH. Kompensimi i sasisë me cilësi duhet të jetë një nga parimet e strukturës së re të FASH. Modernizimi i FASH me armatime, teknike, dhe pajisje e sisteme moderne mendoj se duhet të zhvillohet në përputhje me objektivat e planit afatgjatë, duke synuar plotësimin e kapaciteteve operacionale për pjesëmarrje në misionet brenda dhe jashtë vendit.

Së shtati, jam dakord që sistemi i Arsimit, Trajnimit, Stërvitjes dhe Vlerësimit të FASH kërkon një reformim të kujdesshëm. Bie dakord që ky sistem duhet përshtatet me spektrin e ri të misionit të FASH, si vend anëtar i NATO-s. Krahas misioneve tradicionale, ky sistem duhet të ketë një fokus të ri mbi arsimimin dhe stërvitjen e personelit dhe njësisë të FASH për

misionet e reja të luftës asimetrike, për ekipet e trajnimit dhe këshillimit të misionit “Resolute Support” pas vitit 2014 në Afganistan, si dhe për misione të tjera ku Shqipëria mund të kontribuojë për paqen dhe sigurinë globale.

Së teti, mendoj se reformave të mbrojtjes në planin afatmesëm duhet tu alokohet një mbështetje financiare e pranueshme. Kjo sepse pa këtë mbështetje, mund të rezultojë kritike zhvillimi i kapaciteteve ushtarake për përmbushjen e misionit të FASH. Jam vënë në dijeni, se mbështetja financiare e FASH pas anëtarësimi të Shqipërisë në Aleancë, ka pësuar një rënie në kuadrin e vështirësive financiare. Por, mendoj se për kryerjen e reformave të mbrojtjes, si ato të motivimit të personelit, të operacionalitetit, të stërvitjes, të mbështetjes, të modernizimit, të kontributeve ndërkombëtare, kërkohet që kjo mbështetje financiare të rritet në mënyrë graduale, përndryshe vihen në rrezik arritja e objektivave të RSM-2013.

Dhe së fundi, por jo për nga rëndësia, nënvizoj menaxhimin me kujdes maksimal të çështjeve sociale të reformës së mbrojtjes. Zbatimi i ligjeve në fuqi për personelin ushtarak dhe civil që del në reformë është një element social që duhet të shoqërojë reformën e mbrojtjes. Ministria e Mbrojtjes informoi për masat e marra që reformat të kenë sa më pak efekte sociale. Jam i bindur se jemi në një mendje, që me gjithë përpjekjet e deritanishme, mbetet shumë për të përmirësuar gjendjen e motivimit të personelit në FASH, duke e krahasuar me strukturat analoge të vendeve të rajonit apo me struktura të ngjashme brenda vendit. Rasti i trajtimit të punonjësve të policisë së shtetit mund të shërbejë si shembull për të vlerësuar mundësitë e trajtimit edhe të personelit të Forcave të Armatosura në kuadrin e reformës së mbrojtjes.

Në shtesë, të dy çështjeve që u diskutuan në këtë takim, dëshiroj të informoj këtë audiencë, që bazuar në praktikën e deritanishme të funksionimit (në fakt mos-funksionimi si duhet) të Këshillit të Sigurisë Kombëtare, kam planizuar dhe do të ndërmarr një proces vlerësimi dhe konsultimi me të gjithë aktorët e sigurisë kombëtare. Eksperiencia ka treguar, dhe shpresoj të jemi të gjithë dakord që terminologjia dhe korniza e ligjit për Pushtetet dhe Autoritetet e Komandimit e të Drejtimit Strategjik të FA, nuk është relevant me kohën dhe nevojën që ka kryetari i Shtetit për t'u këshilluar për vendimmarrjet për çështjet e sigurisë strategjike, të cilat sigurisht nuk janë vetëm çështje ushtarake. Qëllimi është që të zgjerohet spektri, aktorët, dhe në mënyrë të veçantë të rritet efektshmëria e këtij forumi. Ju siguroj se, edhe në këtë proces askush nuk do jetë i përjashtuar. Përkundrazi, siç e përmenda, në vijimësi do të konsultohem me Parlamentin, partitë parlamentare, modelet e vendeve të NATO-s, si dhe aktorë të shoqërisë civile që merren me çështjet strategjike të sigurisë.

Me këtë rast, më lejoni gjithashtu t'ju siguroj se si President i Republikës dhe Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, mbetem plotësisht i vetëdijshëm dhe i vendosur për të ushtruar me cilësi dhe përkushtim maksimal të gjitha autoritetet që më jep Kushtetuta dhe ligji në fushën e sigurisë kombëtare. Për këtë qëllim, si Kryetar i Këshillit të Sigurisë Kombëtare, do të jetësoj një agjendë vjetore të këtij Këshilli për ta shndërruar atë në një mekanizëm aktiv të sigurisë kombëtare të Shqipërisë dhe shqiptarëve.

Ju faleminderit!

Burimi: president.al



Ministrja Kodheli: Do të punoj fort për dërgimin e parë të një ushtarëve profesioniste në operacione luftarake

Në Ministrinë e Mbrojtjes krentohet 8 marsi, "Dita Ndërkombëtare e Gruas"

Paraditen e datës 7 mars 2014, në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes u zhvillua një ceremoni festive me rastin e 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas. Në sallën e mbushur plot me gra dhe vajza që shërbejnë nën uniformë, por edhe si punonjëse civile në Forcat e Armatosura ishte krijuar një atmosferë mjaft festive dhe mbresëlënëse. Akoma më të bukur dhe më festiv e bëri këtë aktivitet prania e ministres së Mbrojtjes, Mimi Kodheli, shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, drejtorë dhe ushtarakë të tjerë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm, si dhe e mjaft grave ish-ushtarake që kanë shërbyer prej vitesh në strukturat e Forcave të Armatosura. Pas fjalës së hapjes që mbajti kolonel Manushaqe Shehu, drejtoreshë dhe Drejtoreshë të Marrëdhënieve Civile-Ushtarake, gratë të pranishme në këtë ceremoni i përshëndeti ministrja e Mbrojtjes Kodheli. Në këtë takim festiv me gratë përshëndeti edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Jeronim Bazo. Në mbyllje të këtij aktiviteti, ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, i dhuroi buqeta me lule grave më të vjetra që kanë punuar dhe punojnë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm. Më poshtë, fjala e plotë e ministres Kodheli në takimin me gratë me rastin e 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas:

Përpara se të filloj këtë përshëndetje për ju të dashura zonja, nëna, motra, shoqe, kolege, bashkudhëtare, dua të përmend një ngjarje tragjike me pasoja vdekjen e dy zonjave. Ngjarja ndodhi dje, kur një autobus me gra, të cilat ishin nisur për të festuar festat tona të dashura, bëri një aksident. Këto gjëra nuk duhet dhe nuk mund të ndodhin më në një vend si i yni, që megjithëse e ka të gjatë e të vështirë rrugën e ngritjes, nuk e ka të pamundur. Dhe arsyeja më e parë pse nuk e ka të pamundur vendi ynë të eci në rrugën e drejtë e të sigurt për një të ardhme më të mirë, jeni pikërisht ju dhe të gjitha gratë shqiptare kudo që janë. Ndaj kërkoj që të reflektojme lidhur me këtë që unë ndaj miqësisht me ju. Sepse ne mundemi, sepse ne, me gjithë respektin për pjesën tjetër të shoqërisë, jemi pjesa më vitale, më besimplotë për të ardhmen e fëmijëve tanë. Po që ta bëjmë këtë të ndodhë, na duhet shumë më tepër se çfarë kemi bërë deri sot, të luftojmë, të punojmë dhe të besojmë se Shqipëria e gjeneratës tjetër, është Shqipëria e gjeneratës që ne do të lëmë në duart e fëmijëve tanë. Këtë mund ta bëjnë të mundur dhe do ta bëjnë të mundur nënat shqiptare kudo që janë. Për fat këtë vit, 8 Marsi qëllon në fundjavë



Ministrja Kodheli: E them shpesh herë me shaka, e ndaj edhe në formë "provokimi" me gjeneralët e nderuar, nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm dhe tek të gjithë drejtuesit, se nuk do të largohem pa firmosur, ose më mirë të them pa propozuar, për gradim Gjeneral një grua. Ndoshta jemi pak larg këtij rrugëtimi, por unë ju siguroj se do të jem këtu për t'ia bërë më të lehtë çdonjërit prej jush rrugëtimin tuaj drejt rrugës profesionale, trajnimit tuaj, gradimit tuaj, pse jo edhe marrjes së yjeve të gjeneralit mbi supet tuaja të brishtë, por të fortë.

dhe shpresoj shumë që kjo fundjavë të jetë jo fundjava e punëve dhe intensitetit të zakonshëm në shërbimin që ne i bëjmë familjarëve tanë, por në fakt të jetë një fundjavë më e gëzueshme pranë familjes

apo pranë shoqërisë, por gjithsesi një festë për të gjithë ne. Në fjalën time do doja në fakt të largohesha nga klishetë e rasteve të tilla dhe të ndaja me ju disa momente krejt personale, mbase rasti i

tillë është, gati-gati është dhe momenti apo dhe vendi për të cilin ne jemi mbledhur sot. Unë kam pasur fatin të rritem në një familje tërësisht të emancipuar, ku ne femrat ishim tërësisht të qarta për barazinë edhe rolin që kishim në familje dhe në shoqëri, i cili në fakt ishte ai rol që duhet të ketë gruaja, nëna, motra shqiptare në të gjitha familjet. Por për asnjë moment, për fatin tim të mirë, nuk jam ndërë inferiore edhe kur dola në shoqëri, edhe kur njoha shokun tim të jetës, edhe kur u bëra nënë, edhe kur fillova një karrierë që jo domosdoshmërisht është karriera më e thjeshtë, madje as profesioni më i thjeshtë, ai profesion që unë bëj sot. Por, kur kam parë përfaqësimin, kam ndërë diskriminimin që i bëhet gruas shqiptare. Ne në fakt jemi një shoqëri që flasim për parime, flasim për vlera, madje flasim edhe në emër të tyre, por nga e thëna në të bërë, na ndan më shumë se çka proverbi popullor na mëson. Kur mu propozua fillimisht nga kryeministri Rama, të bëhem ministre e Mbrojtjes, një nga gjërat që më shkoi ndër mend nga të parat ishte padyshim, përtej respektit, besimi që kishte treguar ndaj personit tim dhe barazia gjinore. Unë që nga shtatori i vitit të kaluar, kurse ju që prej shumë kohësh më parë, punojmë në fakt në një ambient, le ta themi, thellësisht mashkullor. Por përtej faktit se ky është një profesion "i shpikur për burra" dhe ku diskriminimi ndihet, kjo në asnjë moment të punës time, nuk e ka ndaluar entuziazmin tim për të besuar tek barazia gjinore edhe në një fushë siç është ajo e Mbrojtjes. Ndaj unë, në mënyrë të veçantë ju përgëzoj nga thellësia e zemrës, sepse

e di që karriera juaj, rruga juaj, sidomos për zonjat që janë me uniformë, nuk ka qenë dhe nuk do të jetë e lehtë. Megjithatë ju përgëzoj juve vajzave dhe grave, plot 1100 të tilla, që në fakt aderoni në strukturat e FA dhe sot jeni më shumë se 10% e të gjithë FA. Ndaj dua një duartrokitje për zonjat civile, në respekt të zonjave që janë të veshura nën uniformë. Keni vetëm komplimentet e mia për gjithçka keni mbërritur në jetë. Por sot nuk jam këtu për të dhënë vetëm komplimente, sot shpresoj shumë dhe do të punoj fort që në pozicionin tim si ministre e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë të firmos urdhrin e parë të dërgimit të një ushtarëve profesionist në operacionet e mirëfillta luftarake, paqeruajtëse ose jo, jashtë atdheut. E them shpesh herë me shaka, e ndaj edhe në formë "provokimi" me gjeneralët e nderuar, nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm dhe tek të gjithë drejtuesit, se nuk do të largohem pa firmosur, ose më mirë të them pa propozuar, për gradim Gjeneral një grua. Ndoshta jemi pak larg këtij rrugëtimi, por unë ju siguroj se do të jem këtu për t'ia bërë më të lehtë çdonjërit prej jush rrugëtimin tuaj drejt rrugës profesionale, trajnimit tuaj, gradimit tuaj, pse jo edhe marrjes së yjeve të gjeneralit mbi supet tuaja të brishtë, por të fortë. Me shpresën se prezenca ime në përbërje të ministrave NATO, e ka rritur numrin e prezencës së grave në përgjithësi, sepse mbas emërimit tim, një zonjë e nderuar nga Norvegjia, pastaj një zonjë nga Gjermania e më tej një italiane, iu bashkuan klubit të grave ministre të Mbrojtjes. Unë besoj se shekulli në të cilin jetojmë, do të jetë shekulli i grave. Uroj shumë që ne të mund të bëjmë atë që, megjithëse shumëkush e di, por nuk e thotë, e ndjen, por nuk e shfaq, është roli i pazëvendësueshëm dhe i patjetërsueshëm i gruas në shoqëri. Ndaj, duke iu uruar nga zemra edhe njëherë për shumë vjet 7-8 Marsin, ju uroj shëndet ju, familjeve tuaja, të dashurit tuaj, fëmijëve, atyre që për ne janë ndoshta arsyeja pse çdo ditë të ditës tonë çohemi, vishemi dhe luftojmë, që është në fakt gjëja më e jashtëzakonshme që mund t'i ndodhi një gruaje, të pasurit e një familje, të pasurit e trashëgimisë tonë gjenetike dhe shpirtërore që ta bëjë shoqërinë shqiptare të jetë akoma më e mbarë, e fortë, e shëndetshme. Ne të gjitha kemi nevojë për të, sepse ne të gjitha mbi gjithçka kemi një emërues të përbashkët, të kujdesemi për të ardhmen e Shqipërisë, të shqiptarëve nëpërmjet përkujdesjes që kemi për brezat që vijnë pas nesh.

Kuvendi i Shqipërisë mbledh gratë deputete nga të gjitha trevat shqiptare

Dita ndërkombëtare e të drejtave të gruas u kremtua ndryshe këtë vit në Kuvendin e Shqipërisë në një forum të hapur me temë "Sfidat e gruas shqiptare në mileniumin e tretë" që u organizua nën kujdesin e zonjës Mesila Doda, kryetare e Aleancës së Grave Deputete në Kuvendin e Shqipërisë. Dhjetëra gra deputete, politike, intelektuale, drejtuese të institucioneve të pavarura, përfaqësuese të trupit diplomatik, përfaqësuese të shoqërisë civile, gazetarë nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia u mbledhën sot për të diskutuar dhe për të ndarë shqetësimet mbi respektimin e të drejtave të grave në Shqipëri dhe rrugët që do të mundësojnë grave një përfaqësim më të madh në vendimmarrje dhe kapërcimin sfidave në të ardhmen. Seanca e posaçme u kryesua nga zonja Flora Brovina, si aktivistja dhe politikania më e vjetër që prej vitesh lufton për të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe të grave në veçanti. Në fjalën e hapjes, kryetarja e Aleancës së Grave Deputete shqiptare, zonja Mesila Doda u uroi mirëseardhjen të gjitha zonjave të pranishme dhe theksoi se deputetet shqiptare duhet të nisin një Lëvizje të Përbashkët të Gruas Shqiptare dhe të krijojnë një forum të përherëshëm mes grave të trevave shqiptare. Ministrja e Mbrojtjes, Mimi



Kodheli, në diskutimin e saj, tha se është një arritje që numri i grave në vendimmarrje është rritur, duke nënvizuar se gjatë gjithë këtyre viteve gratë deputete, pavarësisht nga bindjet politike kanë ngritur zërin e tyre të brishtë, por të vërtetë për të drejtat e grave. "Duartrokitje për ato zonja që për 20 vjet me radhë e kanë bërë këtë sallë arenë që ne sot të mund të flasim për të drejtat tona. Gjërat ndryshohen vetëm nëse ne jemi të gjitha së bashku. Ndryshe luftën e kemi të humbur. Jam besimplotë që do ta fitojmë këtë betejë dhe jam besimplotë se ky shekull është shekulli i grave dhe pse jo i grave shqiptare kudo që janë në të gjitha trevat," tha zonja Kodheli.

Pas diskutimeve, deputetet e Kuvendit të Shqipërisë, të Kuvendit të Kosovës dhe të

Parlamentit të Maqedonisë, miratuan së bashku një deklaratë ku zotohen se do të punojnë më shumë për forcimin e rolit të gruas në shoqëri. Në deklaratën e përbashkët, ato shprehin angazhimin për krijimin e një forumi të përbashkët politik të përherëshëm mes grave shqiptare përfaqësuese politike të së gjithë trevave si dhe angazhimin për të sjellë përfaqësimin në institucionet drejtuese në nivelin e kuotës natyrore 50%. Në përmbyllje të punimeve të seancës, deputetja znj. Valentina Leskaj, pasi falënderoi gratë deputete, por dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile për pjesëmarrjen, propozoi shtrirjen e këtij projekti edhe në nivel rajonal në të ardhmen. "Le të jetë projekti i një udhe të përbashkët, por jo vetëm i joni, por i një udhe të përbashkët i të gjitha grave të rajonit"- theksoi znj. Leskaj.

Deklarata e Përbashkët

Tiranë, më 8 mars 2014
Ne gratë shqiptare të Kuvendit të Shqipërisë, të Kuvendit të Kosovës, të Parlamentit të Maqedonisë, mbledhur sot më 8 mars 2014 në sallën e Seancave Plenare të Kuvendit të Shqipërisë, duke shprehur dëshirën tonë për të konsideruar takimin e sotëm si një hap të parë për promovimin e fuqizimit të gruas shqiptare, deklarojmë:
-Krijimin e një forumi të përbashkët politik të përherëshëm mes grave shqiptare përfaqësuese politike të të gjithë trevave;
-Angazhimin tonë të përbashkët për të sjellë përfaqësimin në institucionet drejtuese në nivelin e kuotës natyrore 50%;
-Shkëmbimin e eksperiencave në të mirë të legjisllacionit që ushtrohet për përmirësimin e rolit të gruas në shoqëri;
-Krijimin e një rrjeti parlamentar për përmirësimin e legjisllacionit në fushën e dhunës në familje si një dukuri e cila i heq dinjitetin gruas dhe dëmton thellësisht familjen shqiptare;
-Mbështetimin krijimin e kushteve për një grua më të arsimuar, më të shëndetshme, me të drejta më të plota me ato të burrave në familje, shoqëri, në politikë;
-Duke u bërë të gjitha bashkë sot, i japim jetë një lëvizje pro gruas në të gjithë trevat tona;
-Duke u bërë bashkë që të fuqizojmë kombin shqiptar në kuadër të vizionit dhe vlerave euro-atlantike.
-Të gjitha bashkë do të reagojmë si një e vetme sa herë liria jonë sfidohet, sa herë jeta jonë cenohet nga dhunuesit e lirisë.

Përfundon me sukses me "Kursin e Lartë të Oficerit", stërvitja "Veçiku 2014"

KLO, perfeksionon procesin e vendimmarrjes ushtarake

Kolonel David Rroku

Kursantët e Kursit të Lartë të Oficerit (KLO), nga data 04.03.2014 deri më 12.03.2014, në ambientet e Akademisë së Forcave të Armatosura, zhvilluan stërvitjen e planëzimit "Veçiku 2014". Në këtë stërvitje, akademistët e KLO-së, u organizuan si Shtab i Forcës së Bashkuar në operacion mbrojtës. Qëllimi i kësaj stërvitjeje ishte aftësimi i akademistëve në analizimin e situatës politiko-ushtarake në periudhë krize dhe konflikti, si dhe njohja dhe përvetësimi nga ana e tyre e koncepteve bazë të drejtimit të FA në nivelin operativo-strategjik. Disa nga objektivat që kjo stërvitje synoi të realizonte ishin:

- Kuptimi i planëzimit operacional të operacionit të përbashkët të FB në një skenar të mundshëm krize apo konflikti;

- Analizimi dhe vlerësimi i ndikimeve politike e ushtarake në nivel operativ e strategjik, për një operacion mbrojtës dhe marrja në konsideratë e faktorëve kyç në planëzim;

- Unifikimi i metodave dhe procedurave të punës për organizimin dhe planëzimin e operacioneve të përbashkëta;

- Perfeksionimi i koordinimit midis fushave bazë në një Shtab dhe midis komponentëve përbërës në operacion;

- Ndërthurja e problemeve midis planëzimit të operacioneve ushtarake me problemet që lindin nga spektri politiko-ushtarak.

Kuptimi, perfeksionimi e organizimi i planëzimit të fazave të operacioneve ushtarake në përputhje me përcaktimet doktrinare dhe kufizimet e përcaktuara nga udhëheqja politiko-ushtarake si dhe të koordinohen veprimet me strukturat civile kombëtare, strukturat e sigurisë dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm dhe planëzimi i masave të përbashkëta në interes të përmbushjes së misionit, duke pasur reference, paketën ligjore mbi detyrimet e ndërsjella për shkëmbim informacioni. Risi dhe sfidë njëkohësisht e kësaj stërvitjeje, ishte se në këtë stërvitje për herë të parë janë marrë parasysh në vija të përgjithshme skenarët e përcaktuar në Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes (RSM). Risi tjetër e zhvillimit të kësaj stërvitjeje, ishte dhe implementimi në gjithë procesin e planëzimit, i detyrave të vëna nga SHSHP të FA, Gjeneralmajor Jeronim Bazo, në takimin e zhvilluar pak kohë më parë, në lidhje me botimet e reja (AJP-5 Planizimi në nivel operacional) dhe aplikimin e tij në standardet stërvitore, në auditorët e AFA. Serioziteti, përgjegjësia, mbështetja, ndërveprimi e bashkëpunimi i të gjithë stafit akademik të Departamentit të Operacioneve në përgatitjen për zhvillimin e stërvitjes, u reflektua dhe në përgatitjen e kursantëve të KLO. Kursi i Lartë të Oficerit, i cilësuar si kursi i nivelit më të lartë dhe një nga subjektet më të rëndësishme të procesit të arsimimit, jo vetëm të AFA e KDS, por edhe në rang Force



Stërvitja e planëzimit "Veçiku 2014", është planifikuar nga departamenti i operacioneve edhe si parapërgatitje e kursantëve (në rolin e shtabit), për t'u aftësuar si leadership ushtarak i së nesërme, të gatshëm për të marrë vendime të rëndësishme, në situata të ndryshme luftarake e joluftarake. Edhe njëherë, gjatë zhvillimit të stërvitjes, të bie në sy ndërthurja e të gjithë elementëve dhe njohurive të marra dhe në fushat e tjera si ajo e strategjisë, e leadershipit. Kjo parapërgatitje konsiston edhe në funksion të zhvillimit të disa stërvitjeve të tjera të mëvonshme si; stërvitje planëzimi për EC, stërvitje planëzimi në kuadër të një force shumëkombëshe për operacionet e mbështetjes së paqes, duke përfunduar me një stërvitje komando-shtabi me pjesëmarrjen e KLO dhe KKSHP.



të Armatosur, në zhvillimin e kësaj stërvitjeje, nuk mbeti jashtë vëmendjes edhe të titullarëve të institucionit. Zv/komandanti i KDS, kolonel Ruzhdi Kuçi, komandanti/Rektori i AFA, kolonel Prof. Asc. Dr. Agim Sula, Dekani i Fakultetit të Sigurisë dhe Mbrojtjes kolonel Prof. Asc. Dr. Gëzim Mustafaj dhe i gjithë departamenti i operacioneve ndoqën nga afër jo vetëm planizimin në ambientet e Akademisë së Mbrojtjes, por edhe daljen në terren për planin e përnjohjes. Zv/komandanti i KDS, vlerësoi përgatitjen serioze të shtabit në "role player", komandanti/Rektori i AFA, vuri theksin në kujdesin që duhet treguar gjatë trajtimit nga ana ligjore e përcaktimit të situatave aktuale e të pritshme, dallimet e mundshme midis

tyre, si dhe implementimin e zinxhirit të komandimit në to.

Ky proces është duke u zhvilluar në përputhje me standardet që ofron Aleanca në të cilën tashmë jemi të integruar, si dhe në konsulencë të plotë me të gjithë stafin e departamentit të operacioneve dhe departamentit të kursantëve. Stërvitja e planëzimit "Veçiku 2014", është planifikuar nga departamenti i operacioneve edhe si parapërgatitje e kursantëve (në rolin e shtabit), për t'u aftësuar si leadership ushtarak i së nesërme, të gatshëm për të marrë vendime të rëndësishme, në situata të ndryshme luftarake e joluftarake. Edhe njëherë, gjatë zhvillimit të stërvitjes, të bie në sy ndërthurja e të gjithë elementëve dhe njohurive

Gati operacioni i dy certifikimeve të reja nga Brigada Logjistike

Zëvendëshefi SHPFA gjeneralmajor Viktor Berdo inspekton procesin e certifikimit në grup, depot e Mbreshdhanit, Vërtoptit dhe Guakut, në Qarkun e Beratit

Zëvendëshefi i shtabit të Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Shqipërisë gjeneralmajor Viktor Berdo inspekton grup depot e Mbreshdhanit, Vërtoptit dhe të Guakut, në Qarkun e Beratit. Në prag të certifikimit të këtyre depove në ditët e pra të prillit 2014 zoti Viktor Berdo i shoqëruar nga komandanti i Brigadës Logjistike gjeneralbrigade Syrja Gjoka si dhe komandantët e sapo emëruar të batalioneve të kësaj brigade kontrolluan me imtësi pastrimin e tuneleve të Mbreshdhanit në Malin e Shpiragut. Të 9 tunelet e këtij rajoni janë pastruar plotësisht nga municionet xheniere për gati dy muaj dhe tani janë gati për certifikim. Gjeneralmajor Viktor Berdo kontrolloi me imtësi tërë tunelet, por dhe ish spitalin dhe ambientet e tjera, falenderoi për punën e kryer tërë efektivin e Rajonit të Beratit të Brigadës Logjistike, vlerësoi punën e tyre dhe diskutoi me ta gjerë dhe gjatë për të gjithë problematikën e punës dhe si të realizohen sa më mirë dhe detyrat që janë në vazhdim. Inspektimi i dytë u krye në Rajon e Vërtoptit ku ndodhen 11 depot dhe komanda rajonale dhe janë të magazinuara sasi të mëdha municionesh këmbësorie artillerie dhe municione xheniere. Gjeneralmajor Viktor Berdo dhe gjeneralbrigade Syrja Gjoka morën raportimin për tërë punën e kryer nga kolonel Agron Budlla, komandanti i këtij rajoni dhe kontrolluan tërë grupdepot dhe tërë masat e sigurimit teknik dhe masat kundër zjarrit. Në një bashkëbisedim të gjerë me tërë efektivin e Rajonit të Beratit u vlerësua sakrificat dhe përkushtimi i efektivit si dhe për detyrat dhe objektivat e vitit 2014. Komandantët e batalioneve të transportit nënkolonel Arjan Qirko, i armatimit nënkolonel Arjan Rroshi dhe komandanti i batalionit të furnizimit Edmond Doda u njohën me tërë objektet, rrugët e kalimit, sasinë e municionit dhe me detyrat që ata do të kryejnë. Po ashtu dhe në grupdepot e Guakut u bë një inspektim i imtësishëm dhe u lanë detyrat përfundimtare sipas një plani të detajuar, të hartuar nga shefi i operacioneve të Brigadës Logjistike nënkolonel Maks Oralniu. Në këtë inspektim të zëvendëshefit të shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralbrigade Viktor Berdo, u bë tërë bilanci i punës, u vlerësua tërë puna e efektivit të Brigadës Logjistike dhe veçanërisht e komandantit të transporteve nënkolonel Arjan Qirko si dhe e komandantit të batalionit të armatimit nënkolonel Arjan Rroshi si dhe puna e komandantit të batalionit të furnizimit Edmond Doda. Bashkëpunimi i këtyre komandantëve me Qendrën e Asgjësimit të municioneve të drejtuar nga nënkolonel Ajjet Dalti do të finalizojë certifikimin e grupdepove në Mbreshdhan dhe në Guak të Skraparit. U vlerësua puna e tërë efektivit, pasi rrugët janë shumë të vështira. Po ashtu gjeneral Berdo inspektoi dhe ndoqi nga afër punën e Qendrës së menaxhimit të Materialeve për pastrimin, sistemin dhe vendosjen e rregullit ushtarak si dhe inventarizimin e tërë vlerave materiale në ish Bazën e Armatës në Lazaret të Tiranës. Nën drejtimin e kolonel Riza Sheqerukaj në kohë rekord tërë efektivi i kësaj qendre bëri një punë të madhe voluminoze duke pastruar dhe sistemuar një sipërfaqe deposh prej rreth 50 mijë metrash katrore. Gjeneralmajor Viktor Berdo falenderoi tërë efektivin e Qendrës së Menaxhimit të Materialeve për ruajtjen dhe trajtimin e vlerave të mëdha në territorin e Lazaretit në periferinë veriore të Tiranës. Në Peze Helmës prej një jave vazhdojnë përgatitjet për të vlerësuar 15 vjetorin e Qendrës së Menaxhimit dhe Asgjësimit të Municioneve me Eksploziv ku më datën 18 mars 2014 do të bëhet një mësim tregues demonstrativ dhe interpretime të tjera speciale nga efektivi i drejtuar nga nënkolonel Ajjet Dalti dhe i mbështetur nga kapiten Artan Azizi, i cili është dhe pasaporta 15 vjeçare e kësaj njësie me shumë pak vite mbi supe, por me shumë histori.

Bashkim Male

të marra dhe në fushat e tjera si ajo e strategjisë, e leadershipit. Kjo parapërgatitje konsiston edhe në funksion të zhvillimit të disa stërvitjeve të tjera të mëvonshme si; stërvitje planëzimi për EC, stërvitje planëzimi në kuadër të një force shumëkombëshe për operacionet e mbështetjes së paqes, duke përfunduar me një stërvitje komando-shtabi me pjesëmarrjen e KLO dhe KKSHP. Në këtë stërvitje, KLO do të luajë në rol të Forcës së Bashkuar/Përbashkët dhe KKSHP në rol të njësie përbërëse të kësaj force. Ajo që të binte në sy, gjatë procesit të planëzimit, ishte dhe standardizimi dhe puna në grup. Hapësira që departamenti i operacioneve i krijoi KLO, të përzgjedhë dhe ndërtojë vetë strukturën organizative të shtabit, komunikimi në grup me të njëjtin kod etik, me të njëjtin sjellje, me të njëjtin psikologji, sikurse e kërkojnë stadet e sotme të punës në shtab, është një tjetër risi ose sfidë për KLO, për të gjithë këta kursantë, që së shpejti, me mbarimin e kursit, pritet të jenë "Elita e FARSH". Standardizimi nuk është parë thjesht vetëm në pajisjet e në fushën e dokumenteve të planëzimit, në një farë mënyre ai ka një shtrirje pa limit. "Procedura standarde e veprimit", e cila nënkupton përmasë të tierave koor-

dinimin, sjelljen e përvojave konkrete e reale. Kjo, solli dhe atë që, pavarësisht se luhej me një situatë të improvizuar, i gjithë shtabi veproi njëllor siç veproi në një situatë reale. E kush mund ta justifikonte më mirë faktin që në këtë grup, gjen komandantë misionesh, duke filluar që nga misioni i parë e deri tek misioni i fundit "Eagle", komandantë njësisish e repartesh, drejtorë institucionesh ushtarake, ushtarakë që vijnë nga shtabet e NATO-s me specialitete nga më të ndryshmet, ushtarakë nga Forca e Sigurisë së Kosovës, femra ushtarake që vijnë nga pozicione të ndryshme të nivelit më të lartë, atë të SHPFA, ushtarakë nga institucione të tjera të sigurisë, si Garda e Republikës. E gjitha kjo, është një tjetër risi, e që ndikoi tepër pozitivisht në këtë stërvitje. Veprimi me standarde, sipas drejtuesve të stërvitjes, sjell më shumë efikasitet dhe më pak energji të harxhuara kot. Stërvitja "Forca e Bashkuar në operacion mbrojtës Veçiku 2014", përfundoi me plotësimin e përmbylljen e të gjithë procesit të vendimmarrjes ushtarake, nga ana e Kursit të Lartë të Oficerit. Përgatitja e lartë profesionale e kursantëve rezultoi me përfundimin me sukses të kësaj stërvitjeje.

BASHKËBISEDIMI I KRYEMINISTRIT RAMA NË PROMOVIMIN E LIBRIT “HESHTJE E DYFISHTË”, TË GAZETARIT CARLO BOLLINO

“Heshtje e dyfishtë”, e vërteta për armët kimike në Shqipëri

Ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, mori pjesë në promovimin e librit të gazetarit të njohur z. Carlo Bollino “Heshtja e Dyfishtë”, - një libër investigativ mbi të vërtetën e armëve kimike në Shqipëri, - zhvilluar në ambientet e “Teatrit të Komedisë”. Të ftuar në këtë ceremoni ishin Kryeministri i Shqipërisë z. Edi Rama, Kryetari i Kuvendit z. Ilir Meta, ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, ministri i Punëve të Jashtme, Ditmir Bushati, shkrimtarë, ambientalistë, deputetë, gazetarë etj. Në prezantimin e librit, gazetari Carlo Bollino shpjegoi arsyet pse ky libër është titulluar “Heshtja e dyfishtë”. Bollino i referohet heshtjes së protagonistëve kryesore, nga njëra anë një heshtje e qeverisë shqiptare, institucione, apo diplomacisë, dhe nga ana tjetër një heshtje edhe nga ana e negociatorëve amerikanë. Duke shprehur përgëzimet për iniciativën e ndërmarrë nga gazetari Carlo Bollino për këtë libër për lëndët kimike të Sirisë, ministri i Jashtëm shpjegoi ecurinë e bisedimeve me ndërkombëtarët për këtë çështje. Ndërkaq, sipas gazetarit Carlo Bollino “Pala ushtarake ka vepruar më shpejt. Kjo palë e ka diskutuar çështjen dhe në një kohë shumë të shpejtë kanë zgjedhur se cila bazë do të zgjidhet”.

Lidhur me këtë fakt ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli shpjegon ecurinë e ngjarjeve, duke u ndalur tek eksperienca e Forcave të Armatosura Shqiptare lidhur me shpërbërjen e armëve kimike. “Për të gjithë ata që nuk e dinë Forcat e Armatosura, kanë pasur një eksperiencë në shpërbërjen e lëndëve kimike. Sigurisht që unë jam kontaktuar nga kryeministri Rama sepse operacioni përfshinte më së shumti ministrinë time. Një operacion që kërkonte konfidencialitet të madh. Ka një manual që të tilla procese duhet të kenë një distancë të caktuar nga zonat e banuara. Kjo ishte një arsye e mirë dhe e fortë që i bënte punonjësit dhe mua personalisht të lidhur me këtë çështje”, - tha ministrja Kodheli. Duke u ndalur tek rëndësia që kjo çështje të mbahej e fshehtë, ministrja Kodheli tha se të dhënat lidhur me këtë proces nuk ishin të qarta, pasi nuk dihej sasi e lëndëve dhe lloji i tyre. “Ajo që desha të shtoj është se kontaktet kanë qenë intensive, por qëllimi ynë nuk ka qenë që të mbahej e gjithë kjo në mënyrë të fshehtë. Përkundrazi kujdesia dhe trajtimi i kësaj çështjeje na bënte neve të kujdesshëm që ta trajtonim në një situatë ku dhe vetë SHBA ishte e paqartë. Dua të shtoj se nuk dihej sasia e lëndëve, lloji i tyre. Ekzistonte një frikë e madhe mes nesh se jo domosdoshmërisht Assad kishte bërë publike të gjitha lëndët dhe fabrikat ku prodhohej arma kimike, pra nuk diheshin saktë të gjitha përmasat e ngjarjes. Të rreshtuarit e Shqipërisë nga ana u shprehën ashtu si vërtet ishte, dhe



në fakt kërkesa që u bë nga SHBA ishte një qëndrim i drejtë. Ngjarjet rrodhën siç rrodhën por Shqipëria mund të kishte pamundësinë, por kishte eksperiencën që të bënte të mundur mos-dëmtimin e njerëzve të saj”, - tha ministrja Kodheli. Lidhur me qëndrimin e palës ushtarake, ministrja Kodheli tha se “Ata ishin të vetmit që më qetësonin kur siguronin që kjo gjë mund të bëhej. Ndoshta ishin të vetmit që më garantonin që kjo gjë mund të bëhej”.

Kryetari i Kuvendit z. Ilir Meta përgëzoi z. Bollino për publikimin e librit “Heshtja e Dyfishtë” dhe u shprehur se rruga për të shkuar tek e vërteta bazohet tek faktet dhe ruajtja e një distance.

Në përfundim të fjalës së tij z. Meta duke bashkëbiseduar me z. Carlo Bollino, tha se “Do t’ju duhet të shkruani një libër tjetër lidhur me këtë çështje “Qëndrim i Dyfishtë” para dhe pas”. Në vijim, po sjellim të plotë në faqet e gazetës “Ushtria”, bashkëbisedimin e Kryeministrit Rama me gazetarin Bollino, në lidhje me

këtë çështje kaq delikate.

Carlo Bollino: “PO” në parim u keqkuptua si një po përfundimtare. Ti mendon që realisht ka pasur një ekui-vok leksikor me palën tjetër?

Kryeministri Rama: “Ka një film shumë të bukur të Akira Kurosavës ku katër personazhe rrëfejnë të njëjtën ngjarje ku kanë qenë pjesëmarrës, secili nga këndvështrimi i vet. Filmi ka katër ngjarje. Subjekti është ekzaktësisht i njëjti. Të katër e kanë parë ngjarjen, por kur e tregojnë asnjëri nuk gënjën dhe ngjarjet janë 4. Kështu që jam i bindur që nuk gënjëjnë palët në përshkrimin e kësaj ngjarje, por prapë ngjarja nuk është e njëjta. Kur kalon një ngjarje të tillë si protagonist me hir apo me pahir, besoj se është e natyrshme që kur rasti e sjell, t’i kthehesh ngjarjes. Edhe mua ma ka sjellë rasti t’i kthehem ngjarjes dhe të paktën deri sot, unë mendoj që nëse do të rifilloja nga e para, do të bëja të njëjtën gjë. Do të bëja të njëjtën gjë sepse nuk kishte një mundësi tjetër, ose të

paktën unë nuk shikoja një mundësi tjetër. Dhe ne te katër që jemi këtu, përveç teje që na ke mbledhur, kemi komunikuar me njeri-tjetrin në atë periudhë, për arsye jo të lidhura me dëshirën ose mos-dëshirën, por me kontekstin. E kemi pasur të pamundur të komunikojmë me të tjerët, për një arsye shumë të thjeshtë; sepse ne nuk kemi pasur një vendim. S’kemi pasur një vendim për t’i pranuar armët kimike këtu dhe për të marrë pjesë në operacion; s’kemi pasur një vendim për t’i refuzuar dhe për të mos marrë pjesë në operacion. Kemi qenë në një proces të nisur nga zanafilla më e natyrshme dhe më e padiskutueshme, në këndvështrimin tim, për çdo qeveri shqiptare, për çdo kryeministër të Shqipërisë. Në rast se SHBA i kërkojnë Shqipërisë një kontribut, Shqipëria nuk mund të thotë asnjëherë jo, unë nuk e konsideroj. Shqipëria mund të thotë vetëm Po, unë e konsideroj. Pastaj kur vjen fjala, siç erdhi tek operacioni, rrjedha e ngjarjeve e solli që Shqipëria të mos përfshihej në operacion. Por ndërkohë edhe të tjera vende, kishin thënë, Po e konsideroj, dhe njëra pas tjetrës, iu larguan operacionit. Nuk është absolutisht asgjë unike, në rastin tonë, në kontekstin e një aleance strategjike dhe të një pozicionimi që Shqipëria të paktën me fjalë, përmes kryeministrave dhe qeverive të veta, e ka pasur koherent dhe asnjëherë të lëvizshëm. Ne jemi partnerët e SHBA-ve. E konsiderojmë SHBA-të partnerin tonë strategjik. E konsiderojmë pjesëmarrjen në Aleancën Euroatlantike si rreshtim në anën e drejtë të historisë dhe kur duhet të themi “jemi prezentë apo mungojmë”, ne nuk mund të themi mungojmë. Pastaj të tjerat janë pjesë e dinamikës së ngjarjes apo të ngjarjeve dhe heshtja e dyfishtë, nëse mund ta marrim si të tillë, ka qenë e imponuar nga fakti që nuk ka pasur një vendim. Në qoftë se do të kishte një vendim, që nuk do të ishte vendimi final- pasi siç e tha dhe kryetari, vendimi i qeverisë siç do vendim qeverie, do të komunikohet me publikun, do t’i prezantohej Kuvendit, do të diskutohet në Kuvend. E pastaj do të kthehej në një vendim sovran të popullit shqiptar, përmes parlamentit. Për sa kohë qeveria nuk e ka një vendim, çfarë do të thotë? Për sa kohë vetë ne ishim njerëzit që diskutonim intensivisht, nuk e kishim një vendim, çfarë do të thotë?

Çështja ishte kaq e mprehtë, kaq komplekse, kaq delikate dhe kaq e ndjeshme sa që çdo përpjekje e jona për të komunikuar, në kushtet kur ne vetë nuk kishim marrë një vendim, do ta komprometonte plotësisht çdo mundësi për të marrë një vendim, në të kundërt me atë që ishte një kërkesë që erdhi nga sheshi apo nga bulevardi dhe që u kthye pastaj në një kërkesë të shumicës dërrmuese të popullsisë.

I konceptuar, në mënyrë krejt të veçantë nga gazetari, - si një bashkëbisedim, me pyetje dhe përgjigje, - ky promovim bëri protagonistë kryesore politikanë të lartë të vendit, mes të cilëve Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë Ilir Meta, Ministri i Jashtëm Ditmir Bushati dhe Ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli. Së bashku me kryeministrin Rama, në panelin e drejtuar nga gazetari Bollino, ata risollën në kujtesë të publikut, kronologjinë e fakteve dhe ngjarjeve përpara marrjes së vendimit zyrtar nga qeveria shqiptare mbi shkatërrimin e armëve kimike.

Kryeministri Rama: Është shumë më komplekse se kaq. Por një nga gjërat që unë mendoj dhe them unë është se ishim shumë të vegjël për të qenë vetëm në mes të dy fuqive të mëdha, ndërkohë që të terët nuk ishin rreth e rrotull. E ajo shprehja sa popullore, aq edhe metaforike që përdori kryetari se “Shqipëria do të mbajë aq sa ka shpatullat”, ishte besoj ajo që ne të gjithë, jo në këtë formë literale, por e ndjenim gjatë gjithë periudhës kur diskutonim. Shpatullat tona nuk na e mbanin dot një mbipeshë që për 1001 arsye, s’i takonte Shqipërisë ta përballonte e vetme. Ndërkohë që pastaj, këtu u bë një situatë krejt e pamundur për të pasur më shumë kohë dhe faktikisht në atë limit të parë kohor, që jo ne po amerikanët dhe rusët i kishin vënë vetes, ne nuk mund të bënim asgjë më të arsyeshme dhe më të drejtë për Shqipërinë sesa të deklaronim mospërfshirjen në operacion.

Carlo Bollino: Ju nuk keni diskutuar asnjëherë me palën ruse për këtë? Vetëm me palën amerikane?

Kryeministri Rama: Me shumë palë, po jo me palën ruse.

Carlo Bollino: Cila ka qenë atmosfera pas bisedës me John Kerry, kur ju i keni komunikuar një Jo pas vendimit të marrë?

Kryeministri Rama: Unë nga njëra anë duhet të dëgjoja ata që përpiqeshin të shpjegonin dhe pastaj të mbronin me brohoritje argumentin që nuk duhet dhe nga ana tjetër duhet të përfaqësoja dhe ata, kur flisja me Sekretarin e Shtetit, për t’i thënë që nuk mundemi.

Carlo Bollino: Keni folur më me zotin Kerry?

Kryeministri Rama: Ajo ka qenë biseda e disatë brenda atyre ditëve që t’u them të drejtën më kanë dhënë një përmasë tjetër të kuptimit të partneritetit tonë me SHBA-të, që s’ka asnjë lidhje me atë perceptim dhe me atë opinion që është një marrëdhënie diktati, imponimi apo moskomunikimi si të barabartë. Ju siguroj që unë kam mbetur shumë i mbësuar pikërisht nga niveli shumë i lartë i dialogut dhe nga respekti reciprok që pala tjetër, Sekretari i Shtetit dhe të gjithë të tjerët me radhë na kanë rezervuar gjatë gjithë bisedave, pa pasur asnjë moment ndjesinë që këtu bëhet fjalë për “xhandarin e botës që ka kapur për fyti një pulë të rastit dhe i thotë –Ose bëj vezën që dua unë, ose s’do të lë pupël në trup”. Ky është një perceptim që lidhet shumë me revistën “Hosteni” dhe gjithë propagandën 50 vjeçare, që nuk ka lidhje fare me realitetin



e marrëdhënieve tona me SHBA-të.

Carlo Bollino: Në të gjithë këto ditë negociatash, protestash, bisedimesh, çfarë ju ka zhgënjyer më shumë dhe për çfarë keni qenë më shumë krenar?

Kryeministri Rama: Për shaka do të thoja se më ka zhgënjyer më shumë Sazani. Por kjo për shaka. Ndërkohë, jo për të kundërshtuar Sazanin se nuk ma lejon detyra, por për të bërë një nënvizim që më duket i rëndësishëm. Nuk është se vendimi përfundimtar që unë pastaj e bëra publik, ishte rezultat i presionit të Sazanit dhe i të gjithë atyre që ishin në bulevard që kishin një të drejtë shumë të madhe (ata, jo Sazani). Është e kundërta. Është ajo që unë e kam thënë që atë ditë dhe kur më është dhënë mundësia të flas: Nuk ishin kushtet, pra jo se ishte protesta, por se protesta kishte më shumë gravitet sesa ç'kishte gravitet projekti. Ajo që unë e konsideroja problemin më të vogël për t'u trajtuar me publikun, ishte ajo që Sazani dhe grupi i vogël që e nisi këtë punë, e konsideroi problemin më të madh. Nuk ishte ai problemi më i madh. S'rrinte as në qiell dhe as në tokë që SHBA-të dhe jo vetëm ato, por dhe të tjerë sepse pavarësisht se u tërhoqën për sa i takon ofrimin të territorit, nuk u tërhoqën për sa i takon pjesëmarrjes në operacion, me ekspertizë, infrastrukturë, etj, etj, - të angazhonin një operacion të tillë për të hedhur në erë popullin shqiptar. Pra t'ja hiqnin nga duart Asadit dhe t'i sillnin këtu për të shkatërruar Shqipërinë. Ky ishte një absurditet, që fitoi terren në një hapësirë ku paranoja e kombinuar me 50 vjet konspiracione botërore kundër Shqipërisë, funksionoi. Ajo që ishte problem serioz dhe që ne e kemi diskutuar brenda nesh, ishte se vetmia dëmtonte imazhin tonë, si një vend që, fatkeqësisht, për shkak të një historie aspak bujare, që ja kemi bërë vetes, nuk na e kanë bërë të tjerët, - është imazhi i një vendi të varfër, i një vendi të ndotur që u gjet si i varfër dhe si i ndotur për të hedhur edhe këto plehurat e fundit, plehurat më të freskëta të planetit. E, mbi këtë imazh ishte shumë e vështirë të dilje. Theksi që u vu nga gjithfarë burimesh të informacionit lart e poshtë nëpër botë, secila për arsytet e veta, disa për injorancë, disa për konjunkturë, disa për arsye të tjera që janë shumë komplekse, çfarë bënte? Bënte që ne të mbingarkonim vetveten në sytë e të gjithëve, ndërkohe që objektivi ynë është që të ndërtojmë një vend turistik, një vend ekologjikisht sa më të pastër, një vend me një zhvillim bujqësor sa më të pastër, nga pikëpamja e përmbajtjes së vet, mundësisht të kemi sa më shumë prodhime bio, etj, etj.

Në rast se ne do të ishim jo të vetmit, atëherë pjesa tjetër do të ishte shumë më e thjeshtë, sepse nuk mungonin argumentet. Kishte një skuadër të tërë që merrej me ato që ngrinte Sazani me të tjerët dhe siç i merrnim nga Sazani dhe nga të tjerët, ne menjëherë ua vinim përpara ekspertëve me të mëdhenj të botës dhe i thoshim: Po kjo? Po kjo?...nëpërmjet grupit të ngritur në Ministrinë e Mbrojtjes. Dhe ekspertiza më e mirë në botë na jepte përgjigje për të gjitha pikëpyetjet tona. Dhe të gjitha ato (dyshimet) ranë komplet. E vetmja gjë që ne nuk arritëm ta kapërcejmë ishte vetmia e Shqipërisë. Vetmia e Shqipërisë ishte ajo që nxori pjesën më të madhe të njerëzve në rrugë. Vetmia e Shqipërisë ishte ajo që bënte të funksiononte pyetja "Po pse vetëm Shqipëria?". Kjo pyetje ka një përgjigje shumë komplekse. Nuk është dhe e vetmja përgjigje që s'mund të jetë, - është, që e gjetën Shqipërinë për viktimitë. Vetëm kjo s'mund të ekzistojë. SHBA-të ia vunë syrin Shqipërisë dhe thanë: "këta janë të dobët, këta të ndotur janë hajde po ja çojmë dhe këto, t'i hedhim në erë dhe këta po shpëtojnë nga vetja dhe ne po shpëtojmë nga këta". Kjo nuk ekziston. Ky është një absurditet dhe një "nonsense". Ka shumë arsye që mund të shtrohen; vende të ndryshme kanë arsye të ndryshme. Të mos harrojmë që edhe konfiguracioni që u krijua, nuk ishte i zakonshëm. Nuk ishte një operacion i mirëfilli i NATO-s. Ishte një operacion i marrë përsipër nga SHBA-të dhe Rusia. Shtete të tjera kishin qasje të ndryshme. Pra, nuk mund ne t'i mbijetonim një konfiguracioni shumë kompleks dhe një procesi që nga pikëpamja organizative, linte shumë për të dëshiruar. Aq sa në një moment të caktuar, na dukej sikur ne ishim pjesa më e organizuar në këtë histori. Sepse realisht ishim shumë të fokusuar, nga njëra anë për të pasur garancinë 100 % që nga pikëpamja e shëndetit, nga pikëpamja e mjedisit, të mos prekej asnjë fije floku e askujt sot dhe asnjë potencial i të ardhmes së këtij vendi. E nga ana tjetër ishim shumë të fokusuar që të garantoni që politikisht për Shqipërinë, kjo të ishte një fitore e dyfishtë. Një fitore e dyfishtë, nga njëra anë, si një vend i vogël, por i aftë për të marrë një rol prej qytetari global, -se këto janë momente që të jep historia për të dalë nga bataku po i historisë, - dhe nga ana tjetër si një vend që pavarësisht kësaj nuk do të cenohej në strategjinë e vet vend për t'u zhvilluar, si vend turistik etj, etj. Kjo bënte që edhe unë, edhe kryetari, edhe të dy ministrat e përfshirë, të rezononim me publikun. Sa ishin njerëzit që diskutonin për këtë gjë dhe sa ishin njerëzit që

komunikonin për këtë gjë, (flas për ne të ekzekutivit, se kryetarin e informoja në mënyrë sistematike, por ne i bënim diskutimet) aq ishte dhe vetë publiku. Pra, nuk ishim "ne me ata, kundër publikut" apo "ne me publikun, kundër atyre". Ne ishim ata që e përfaqësonin Shqipërinë. Ne ishim ata që përfaqësonin interesat strategjike afatgjata të vendit. Duhet t'i qëndronim të gjithë atyre që i themi në kohë paqeje dhe i qëndruam. Pra, që "ne jemi gati në çdo kohë, kudo që të na kërkojë lufta kundër së keqes, etj, etj". Dhe në momentin e parë kur e keqja u shfaq si një forcë përballë nesh, ne nuk mund të bënim bisht. Sepse në fund të fundit, në rast se të tjerët që janë të rreshtuar në këtë Aleancë, mund të flasin për reciprocitet me SHBA-të, në kuptimin se çfarë kanë dhënë dhe çfarë kanë marrë, ne nuk mendoj se mund të flasin për reciprocitet, kur vjen puna për borxhin që i kemi si komb, si shqiptarë, SHBA-ve, dhe nga ana tjetër borxhin që i kemi vetvetes dhe atyre më të rinjë që fjalët e mëdha për rreshtimin në anën e duhur të historisë dhe për betejat e përbashkëta të mos i ndajmë në vepra.

Carlo Bollino: Pranoni që nëse do kishte më shumë komunikim do kishte ndihmuar?

Kryeministri Rama: Gjëja që përsëri unë nuk e kuptoj, po ndoshta nuk jam në gjendje ta shpjegoj si duhet mbase, është përsëritja e kësaj. Çfarë do komunikoni? Ne komunikim vetëm të vërtetën dhe s'e kemi gënjyer për asnjë sekondë popullin shqiptar. I pyetur a jeni kontaktuar, mua ministri i Jashtëm më ka marrë në telefon përpara se të hynte në konferencë shtypi, më tha kam gjetur një situatë shumë të ndezur nga pikëpamja e interesit, e parashikoj që mund të bëhet një pyetje lidhur me këtë, çfarë duhet të përgjigjem. Unë i thashë: "Duhet t'u themi të vërtetën: Po jemi kontaktuar, por nuk kemi marrë asnjë vendim". Kemi bërë mbledhje me grupin parlamentar, dhe unë i kam thënë të njëjtën gjë. Në të njëjtën kohë të gjithë dëgjonim Sazanin me grupin e vogël atje, që jemi kontaktuar, nuk ka asnjë vendim. Të jeni të sigurt se në rast se ne do të kemi të gjithë informacionin e nevojshëm për të komunikuar me ju, me grupin dhe për të arsyetuar me ju çfarë vendimi duhet marrë, do ta bëjmë. Këtë gjë kemi folur dhe me qeverinë, sepse ndiheshim dhe ne jo mirë, kur shikonim pjesën tjetër të skuadrës, - ne punojmë shumë si skuadër në qeveri, mblidhemi çdo ditë në mënyrë sistematike, në 8 të mëngjesit me grupet e ministrave - dhe ishim vetëm ne të tre që dinim dhe të tjerët i shikonim. Ua

kemi thënë në mënyrë eksplicite: Jemi kontaktuar, është një proces i ndërlikuar, shumë aktorë në linjë dhe ne sapo të kemi një kuadër të përgjithshëm të gjësë, do t'ua bëjmë me dije. E në ato kushte, nga njëra anë, kur çfarë nuk thuhej dhe kur ishte krijuar një front, ne nuk mund të dilnim përballë dhe të flisnim, ndërkohe që do të pyeteshim shumë thjeshtë: Çfarë do të bëni ju? E ne nuk mund të përgjigjeshim: "nuk e dimë akoma, e të tjera diskutime".

Pra ajo ishte një situatë që duhej zgjidhur qartësisht dhe pastaj të dilje para popullit dhe të thoje: "Ne kemi këtë kuadër e për këto çështje dhe aspekte kemi këto përgjigje, dhe ne mendojmë se duhet të marrim pjesë në këtë operacion". Në atë moment do të merrnim vendimin dhe siç e tha kryetari do të shkonim në Parlament e aty do të diskutohej. Duke mos e pasur të gjithë kuadrin të plotë ne do të dukeshim ashtu siç nuk ishim, në fakt. Sikur po fshihnim ndonjë gjë, sikur po thoshim gjysma të vërtetash, sikur po përfshiheshim në një histori që nuk e dinim as vetë se ku do të na çonte. Faktikisht, nga pikëpamja e strategjisë së komunikimit do të ishte një "vetëvrasje". E nga ana tjetër kemi parasysh që dhe pala tjetër kryesore ishte dhe ajo në kontakte të vazhdueshme. Nuk punonim të izoluar. Kishte shumë të tjerë që ishin të përfshirë, kishte pozicione që po ndryshonin përditë. Ne kemi marrë pozicione të reja ditën kur ne e kishim vendosur. Ne kemi marrë pozicione të reja pala të tjera, shumë më pranë asaj që ne kishim kërkuar më përpara, por ishte tepër vonë. Qëllimi ynë ishte që Shqipëria nga ky operacion të dilte më e fortë dhe më e pastër. Ne e realizuam pothuajse njërin pjesë se ndërkohe mos mendoni që gjëja zhvillohej në një terren, që ishte i qartë për të gjithë. Të gjithë kishin paqartësitë e tyre. Ne mbronim interesin e Shqipërisë dhe kërkonim pjesën tonë, në kuptimin e mirë të fjalës, të investimit dhe të kthimit të këtij investimi. Ne bënim një investim të madh për njerëzimin. Nga ana tjetër për kushtet tona, ne meritonim të kishim pjesën tonë të mbështetjes. Ne arritëm pak nga pak, ta çojmë çështjen aty ku donim. Nuk arritëm dot të thyejmë vetminë. Nuk kishim fuqi ta bënim. Dhe në atë moment vetmia ishte e papërbalueshme, për atë që u thashë, pra në qoftë se ne do të fitonim stretegjikisht, politikisht dhe do të bënim një investim shumë të rëndësishëm në këtë partneritet ushtarak dhe politik, ne do të humbim përsëri politikisht, por në strategjinë tonë të zhvillimit të një vendi, që asetin e vet më të bukur ka bukurinë dhe që fatkeqësisht trashëgon një imazh

shumë të rënduar si një vend problematik, i pistë, i varfër, i shëmtuar etj, etj.

Kastriot Frashëri: Ne bëme një detyrë qytetare si specialist. Bëmë mbrojtjen tonë. U bëme avokat të një çështje qytetare, patëm dhe atë rezultat dhe unë nuk e vë fare në dyshim fjalën tuaj zoti Kryeministër, në momentin që ju i thatë JO pamundësisë së vendit për tu bërë pjesë. Po ashtu edhe qëndrimin e zotit kryetar të parlamentit dhe ministrave.

Kryeministri Rama: Të bëj një sqarim se është i rëndësishëm. Për asnjë moment as nuk e thashë por as nuk e kam menduar ndonjëherë që ju ambientalistët kishit ndonjë interes anti- amerikan, ose ndonjë qëndrim anti-amerikan. Të tjerë në atë zallahi kishte që e kishin dhe këtë, por ajo ishte një konglomerat i madh. Unë kam menduar dhe mendoj që ju si ambientalistë dhe si ekspertë arritët të impononi mendimin tuaj se ishit vetëm. Nuk patët përballë ekspertët e vërtetë të kësaj fushe, që nuk dolën sepse nuk ju erdhi momenti për të dalë. Kjo është ajo që mendoj unë, nga njohja ime për shkak të detyrës, se unë nuk jam ekspert, por nga njohja ime për shkak të detyrës dhe po jua përsëris, çfarë thoshit ju kishte një skuadër që për të mirën e Shqipërisë, në respekt të protestës, në respektin tuaj, që i shënonte të gjitha, komplet. Të gjitha ato që ju i tregonit si shkencore ne i përballonim me shkencëtarë, po me shkencëtarë real. Për të gjitha ato ne merrnim përgjigje. Kështu që shkencërisht nuk ka asnjë bazë frika nga ky operacion, është shkencërisht e pabazuar. Ajo që ka bazë dhe që përsëri mbetet pjesa më spektakolare e asaj historie, është protesta qytetare. Kishte shumë gjëra aty brenda, po të paktën në këndvështrimin tim, unë kështu e fillova bisedën dhe thashë që katër njerëz në të njëjtën ngjarje, tregojnë katër ngjarje të ndryshme secili. Kjo është ngjarja ime. Pjesa e shqetësimit që u ktheu pastaj në një manifestim të refuzimit nga vetmia. Unë jam i bindur që sikur pyetja, që u bë si çekiç, "Pse vetëm ne?", mos të ekzistonte, ngjarjet do kishin rrjedhur tërësisht ndryshe. Por kjo nuk mund të provohet, është një hipotezë. Ajo që të paktën besoj nuk është një ngushëllim i vogël, është që e gjithë kjo ndarje emocionesh, mendimesh, qëndrimesh në këtë bashkësi u zhvillua si asnjëherë tjetër me qytetari, me vullnet të pazakontë të pushtetit, po themi në këtë rast, kam parasysh këtu qoftë qeverinë, qoftë Kuvendin përmes kryetarit, për të pasur vazhdimisht në vëmendje opinionin publik, për të pasur vazhdimin në vëmendje shqetësimet e njerëzve, për të pasur vazhdimisht në vëmendje jo politikisht, po si pjesë e të njëjtës bashkësi, gjithë ndjeshmëritë në mënyrë që të merrej vendimi më i duhur. Dua ta mbyll duke thënë, ne nuk u tërhoqëm, që të jetë shumë e qartë. Ne nuk u tërhoqëm sepse ne nuk kishim marrë një vendim. Ne morëm vendimin e duhur edhe falë jush. Kur them jush, them gjithë atyre që ishin protagonistë në këtë histori, morën vendimin e duhur. Kjo është gjëja e mrekullueshme e asaj historie unikalë. Nuk kishte një qeveri që kishte dalë dhe kishte thënë "ne do bëjmë këtë", pastaj doli populli dhe qeveria tha jo ne nuk e bëjmë këtë. Që edhe mund të ndodhi dhe prapë është në nderin e qeverisë që nuk vret njerëz në bulevard, por që mund të tërhiqet nga një vendim i gabuar. Por ne nuk kishim marrë vendim, ne nuk kishim vendosur përball popullin. Përkundrazi ne ishim mes jush që u thoshit gjithë çfarë donit të përcillnit dhe aleatëve tanë të cilëve ju thoshim gjitha çfarë ne donim të përcillnim, edhe për ju. Dhe kjo është pjesa e bukur e historisë. Unë nuk kam ndërmend të shkruaj një libër për këtë, po besoj që nga të gjithë ne njeriu i duhur e ka bërë, Carlo dhe atij as Sazani s'ka ç'i bën.

Perëndimi mund të fillojë luftën në Siri, por për një gjë të këtillë shtrohet pyetja se a mund ta përfundojë dhe kur

Sprovat siriane...

PROF. DR. MUHAMET RACAJ*

Peng i interesave

Në fillim po përmend një mendim të analistit të njohur izraelit Martin Van Kreveld: "Politik-bërësit dhe të tjerët që mendojnë se mund të shfrytëzojnë në mënyrë racionale forcat ushtarake të shteteve të tyre, për të arritur qëllime politike, duhet të mësojnë leksionin se forca e ushtrisë për interesa është limituar sipas një definicioni, ndërsa aktivizimi i saj kundër luftës jo të instrumentalizuar në të shumtën e rasteve, ka shkaktuar vetëm dështime". Sipas kësaj, në rrethanat konkrete në të cilat gjendet bota, pikëpamjet dhe filozofia bashkëkohore për bazë duhet të kenë këtë qëndrim: "të shmangët lufta ose kanosja luftarake e çdo lloj forme qoftë ajo". Konfliktet e armatosura ndërmjet kryengritësve dhe pushtetit në Siri po zgjasin më shumë se tri vjet, por tani për tani nuk mund të parashihet dhe të thuhet me siguri se si dhe kur do të përfundojë kriza në këtë vend arab. Shumë kronikë, analistë, njohës të zhvillimeve janë të bindur se kryengritja mund të shndërrohet në luftë qytetare dhe të zgjasë me vite, ashtu si në Liban. Edhe pse rezultati dhe fundi janë krejtësisht të pa parashikueshëm, tanimë është e qartë se kriza në Siri është një pasqyrë e një rendi të ri të ardhshëm botëror, i cili duhet tu jap formë marrëdhënieve të ardhshme midis superfuqive. Mund të thuhet se Siria në këtë mënyrë bëhet burim i rendit të ri botëror, me çka shihet edhe rëndësia historike e këtij konflikti, tani për tani lokal. Në Siri, për herë të parë pas Luftës së ftohtë, marrëdhëniet reale ndërmjet superfuqive u shfaqën në formë të haptë, bile mund të thuhet se bëhet fjalë për konflikt të vërtetë ushtarak të superfuqive nëpërmjet ithtarëve të tyre. Kriza siriane gjithashtu është rast i parë në të cilin superfuqitë antagoniste- në njërin anë SHBA dhe anëtarët kryesor të BE, ndërsa në anën tjetër Rusia dhe Kina- nuk bëjnë asnjë tentim për të toleruar, dhe si duket, janë të gatshme edhe për veprime më radikale. Përqendrimi i forcave e konfirmon pikërisht këtë. Amerika i përqendron forcat e veta në Gjirin e Persisë dhe në Mesdhe, ndërsa Rusia tani më i ka stacionuar forcat e veta detare në ujërat siriane dhe në bazën detare në Tartus, ndërsa Turqia përgatit të instalojë sistemet e raketave tokë- ajër në kufi me Sirinë. Nuk është për t'u anashkaluar fakti se edhe Kina ka anijet e veta luftarake në Gjirin e Adenit, i cili nuk është aq larg Sirisë. Në Siri tanimë një kohë të gjatë që janë stacionuar dhe janë aktiv forcat speciale të Britanisë së Madhe, Turqisë, Katarit dhe siç duket edhe të SHBA-së. Tanimë nuk është sekret përfshirja e drejtpërdrejtë ushtarake e Perëndimit. Por edhe Rusia si patron dhe partner strategjik i Sirisë, sipas disa vlerësimeve të analistëve ushtarak, përveç personelit të anijeve, ka edhe rreth dy mijë ushtarakë të forcave tokësore. Një përqendrim i këtillë i forcave ushtarake nuk shpie kah e mira, por dëshmon se diç shumë e rëndësishme është në pyetje dhe se asnjë opion nuk bënë përjashtim.



Prestigji nëpërmjet partneritetit

Për përdorimin e forcës ushtarake vendosin politikanët, dhe jo gjeneralët. Historia dëshmon se ndonjëherë politikanët janë të prirë që ta marrin vendime që nuk janë racionale, siç tregon edhe zhvillimi i deritashëm i krizës në Siri. Nuk do të kishte kurrfarë shpjegimi tjetër logjik fakti se SHBA prestigjin e vet nënotë si i i superfuqisë ushtarake botërore që lidhet me faktin se kush do të ketë pushtetin në Damask. Prestigjin e vet e promovon dhe e lidh për interesat e një pale që ende është si e dyshimtë në këtë konflikt civil, ose mbase mund të bëhet fjalë për luftë. SHBA është në anën e rebelëve, ndërsa bashkë me të, Turqia, Izraeli, Arabia Saudite e të tjera e bien terrorizmin dhe krimin në Siri për të realizuar prestigjin e Perëndimit. Veprimet e ndërmarra kundër qeverisë së Sirisë gjithnjë e më shumë po e humbin dimensionin e paralajmëruar politik dhe në një eufori të përjetimit të forcës fillojnë të duken si forma sektesh të cilat paraqesin interesa të tyre. Keqpërdorimi i religjionit në mungesë të ideologjisë dhe të opinionit praktik shkakton interpretime rigide dhe konservative të Kuranit. Kjo nuk duhet të identifikohet me botën islame, sepse një interpretim i këtillë nuk është në traditën e islamit. Kriza siriane përmban një parametër shumë të rrezikshëm, i cili ka si detyrë që të ndikojë në mënyrë destabilizuese në Lindjen e Afërt, por një ditë, kur kjo krizë e "imponuar" do të përfundojë, ky parametër mund të marrë formë opsionit për radikalizmin e interesave në Ballkan ose në Evropën Perëndimore. Shtimi i kërcënimeve të grupeve radikale islamike në Siri konsiderohet si një nga nxitësit esencial të "partneritetit" amerikano-rus që të gjendet një zgjidhje për Sirinë në bazë të eliminimit të armëve kimike të regjimit në Damask.

Interesa të "partneritetit"

Grupet radikale islamike, të vëna në funksion të problematizimit të përpjekjeve ndërkombëtare për zgjidhjen e krizës, bashkë me arsyetimet e kuluareve, me qëllimin tanimë evident – të vënies së epërsisë ose të ruajtjes së balancimit në skenën botërore, janë shfrytëzuar për tu përleshur me ushtrinë siriane. Pasi janë kundër regjimit të kry-

etarit sirian autoritar Bashar Al Asad, ata luajnë rol kryesor në formimin e frontit të një lufte evidente të sigurt. Me këtë Siria duhet të jetë qendër e terrorizmit global, siç është Afganistani dhe Iraku. Për këtë qëllim luftëtarët radikal islamik në Lindjen e Afërt dhe në Evropë infiltrohen në Siri për "luftë të shenjtë" kundër jobesimtarëve. Brengosës është veprimi i tyre edhe nga aspekti ideologjik. Të frymëzuar nga ideologjia e Al Kaedës bëjnë përpjekje për vënien e konfliktit islamik në Siri dhe në Irak (ISIS) që ka një numër të madhe luftëtarësh të huaj dhe promovon interpretim rigoroz të ligjeve islamike në Siri (ndalim të pirjes së duhanit, gratë të mbajnë fereqhe, ekzekutime publike). ISIS përpiket të zgjerojë dhe të përforcojë

Marrja e vendimeve strategjike me kohë i zvogëlon potencialet për veprimin e grupeve ekstremiste, radikale, terroriste dhe grupeve të tjera ekscentriste, anëtarët e të cilëve janë kthyer nga beteja të ndryshme botërore dhe "idealet" e të cilëve mbeten gjithmonë të dyshimtë.

praninë e vet në Siri duke zbatuar strategji agresive luftarake, përfshirë konfliktet edhe me grupet e tjera rebele. Qëllimi është që të përhapë veprimet e veta për të kontrolluar territorin në Siri, në kufijtë e Turqisë dhe në mënjanimin e marrëdhënieve të tensionuara ndërmjet Ankarasë dhe Damaskut.

Perëndimi mund të fillojë luftën në Siri, por për një gjë të këtillë shtrohet pyetja se a mund ta përfundojë dhe kur. Flaka e luftës në Siri do të përhapet në tërë regionin dhe do të gëlltiste shtete e vogla dhe të dobëta. Në rrezik më të

madh është Izraeli, kundër të cilit do të orientohej mllefi i myslimanëve.

Reperkusionet e krizës

Kriza një ditë do të përfundojë, por kur kjo do të ndodhë rebelët e jashtëm në konfliktin e sirian do të kthehen në vendet e tyre. Kthimi i tyre nëpër shtëpi, në territorin e rajoni (Shqipëri, Bosnjë e Hercegovinë, Bullgari, Kosovë, Maqedoni, Serbi, Kroaci) çështjen e sigurisë do ta vinte para sprovave të reja. Personat e kthyer nga vatrën e luftës siriane me vete bartin potencialin e madh të rrezikut për sigurinë. Dëshira për dominim të përforcuar me radikalizmin ideologjik mbase do të shkaktonte interpretim ekstrem të islamit si "çështje e vetme e drejtë", që gjithsesi do të kishte ndikim negativ ndaj sigurisë së rajonit. Edhe pse bashkësitë islame të Ballkanit zyrtarisht janë kundër shkuarjes së këtyre grupeve në Siri, me arsytimin se nuk bëhet fjalë për interpretim luftë të shenjtë fetare, por për konflikt politik, të nxitura nga interesa personale, hasen megjithatë motive fetar, por më shpesh motive financiare për të shkuar në këtë luftë. Si më ekstremë dhe më të rrezikshëm, të përgatitur për luftë, më radikal në aspektin ideologjik por edhe të lidhur më mirë në aspektin ndërkombëtar me grupet terroriste dhe kriminale, personat që kthehen nga Siria paraqesin një problem serioz dhe real për vendet e Ballkanit, por edhe më gjerë, në Bashkimin Evropian rreth sigurisë së tyre. Mundësia që ata të bëjnë aleancë (të lidhen njëri me tjetrin) dhe të formojnë grupe terroriste nuk duhet përjashtuar kurrsesi apo të marginalizohen në projektimet për krijimin e një regjioni të qëndrueshëm dhe të sigurt. Lidhshmëria potenciale gjithsesi do të ndiqet me mobilizimin e domosdoshëm të forcave të reja për qëllim të përhapjes së radikalizmit ekstrem dhe krijimit të bazës më të gjerë të veprimtimit. Supozimi për qëllimin e zgjerimit të bazës së veprimtarisë ka arsytim për shkak të krijimit të kushteve për një përkrahje më të mirë dhe të përhershme logjistike për realizimin e qëllimeve të tyre "të shenjtë". Realizimi i këtyre qëllimeve do të impononte abuzimin e çështjeve religjioze dhe do të ndikonte në ndjenjat etnike, që do të nxiste "motivet" për të përkrahur këto grupe. Ashpërsia

që është shprehur në betejat siriane, karakteristikat terroriste të mënyrës së veprimit, përvoja e fituar e veteranëve të luftës, por edhe çrregullimi i tyre ideologjik dhe përhapja e radikalizmit fetar në regjion, janë argumente të forta sipas të cilave do të vazhdonin jetën e tyre në atdhe. Është fare pak e sigurt se do të vazhdojnë të jetojnë me familjet e tyre qetë dhe me dinjitet ashtu si kanë jetuar para udhëtimit aventurist të përcjellë me diversione, sabotime, përdorimit të mjeteve vrasëse dhe armëve, vrasjeve për para dhe për ideale. Dominimi i irracionales që i karakterizon këto personalitete me anomali, në masë të madhe sinjalizon rrezikun potencial për sigurinë në shtet dhe tek fqinjët e tij.

Sprovë siguria ose problem

Analizimi i rreziqeve të personaliteteve të transformuar pas luftës, e përcakton raportin ndërmjet sprovës dhe problemit të nivelit të lartë dhe e shpie atë në kuadër të strategjisë ose metodës. Përcaktimi për strategji jep shumë shtetërore. Zgjidhjet e mundshme e shprehin interesin e shtetit për tu mbrojtur nga sprovat me gjetjen e procedurave sistimore dhe miratimin e normave juridike. Përcaktimi metodologjik kërkon aplikimin e masave më agresive sipas kohës dhe vendit për neutralizimin e problemit që paraqitet, që në kushte të caktuara dhe në perceptime të vonuara mund të shkaktojë sprovat të tjera. Aplikimi i forcës për zgjidhjen e problemit të këtij lloji ballafaqohet me rrezikun e interpretimit të saj nga bashkësia ndërkombëtare, që mund ti imponojë problem të ri, përkundër atij që ekziston. Kushtet për të vënë në sprovë janë ende të mëdha.

Konkluzion

Prandaj imponohet konkluzioni se gjatë përcaktimit të rreziqeve nga sprovat ose problemet, zgjidhja përfundimtare e enigmës do të ishte të përballësh me sprovën. Marrja e vendimeve strategjike me kohë i zvogëlon potencialet për veprimin e grupeve ekstremiste, radikale, terroriste dhe grupeve të tjera ekscentriste, anëtarët e të cilëve janë kthyer nga beteja të ndryshme botërore dhe "idealet" e të cilëve mbeten gjithmonë të dyshimtë. Duke marrë mësim nga përvojat e deritashme të Ballkanit të vluar, shteti nuk përmbys vetëm nga jashtë, me përvetësimin e territorit të tij, me dobësimin ose me eliminimin e institucioneve të tij dhe me përmbysjen e forcës së tij. Ai shkatërrohet edhe nga brenda, duke vrarë ndjenjën e shtetësisë tek populli, duke vrarë idenë për shtetin, dhe me këtë edhe idenë për lirinë që i ve themelet për të gjitha çështjet tjera: demokracinë, përparimin ekonomik, mirëqenien, sigurinë.... Nëse për përdorimin e forcës vendosin politikanët, dhe jo gjeneralët, është plotësisht nevoja e miratimit të strategjisë shtetërore për tu ballafaquar me këto sprovat militante duke vepruar në mënyrë parandaluese për ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit të vendit dhe vendeve përreth në Ballkanin i cili mund të ndizet shumë lehtë.

*Gjeneralbrigade
i Forcave të Armatosura të
Republikës së Maqedonisë

Në kuadër të zbatimit të planit mësimor 2013-2014 të "Departamentit të Lidershit dhe Shkencave Shoqërore", "Kursët e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm" (KKSHP) në "Akademinë e Forcave të Armatosura" në datën 5 mars 2014 zhvilluan një vizitë në kompaninë private "Aga Grup". "Aga Grup" ka tashmë akademinë e saj të lidershit. "Aga Leadership Academy", e para e këtij lloji në Shqipëri dhe në Ballkan, ndër të paktat në Evropë, synon të ndihmojë punonjësit të rriten profesionalisht duke iu referuar standardeve më të mira të biznesit bashkëkohor. Ky institucion përfaqëson përpjekjet e biznesit në lidhje me formimin profesional dhe trajnimin e punonjësve të kompanisë së saj. Trajnimi i parë për punonjësit e filloi në datën 27 janar 2012. Akademia ofron tre nivele trajnimi dhe staf të përhershëm trajnesish si edhe profesorë me kohë të pjesshme nga Shqipëria, Kosova, Evropa dhe India. Modulet e Akademisë janë konceptuar me mundësi aplikimi të drejtpërdrejtë në praktikën e biznesit. Duke vlerësuar realisht këtë kontribut që sjell kjo akademi për punonjësit e stafit

Një vizitë mbresëlënëse në "Aga Leadership Academy"

Akademia "e vjetër" takon një akademi "të re"

të saj, vizita e KKSHP të Akademisë së FA ishte konceptuar jo vetëm si një vizitë mësimore, por si një realitet në të cilin, teoritë e lidershit ushtarak nuk mund të konceptohen vetëm në kuadrin e përgjegjësiave ushtarake. Akademia e lidershit të kësaj kompanie ishte pikërisht një materializim konkret dhe i matshëm në treguesit; cilësor të zhvillimit të stafit akademik dhe profesionalizmit të punonjësve si dhe atë sasior, në rritjen e treguesve të biznesit. Gjithkush që njeh dhe zotëron programin e lidershit në

AFA është në gjendje të kuptojë lidhjen organike që ekziston ndërmjet teorisë e praktikës, të cilën mund ta gesh pikërisht pranë kësaj Akademie me një emër të nderuar në rrugën e biznesit. Gjatë zhvillimit të vizitës, Kursantëve të KKSHP iu rezervua një pritje e veçantë nga presidenti i këtij Grupi, Vasil Naci dhe nga drejtori i Burimeve Njerëzore Artan Koçuku. Ata i njohën kursantët me historikun e kompanisë në përgjithësi dhe mbi funksionimin e "Aga Leadership Academy" në veçanti. Në fokus të prezantimit të

tyre ishte rruga e gjatë dhe vështirë e ndjekur nga kjo kompani që nga hapat e para modeste dhe spontane në fillim të viteve 90, e deri në ditët e sotme, gjendja aktuale, pritshmëria dhe planet afatgjata. Prezantimi përfshiu edhe projektin e akademisë së lidershit, e cila duke parë ritmet e zhvillimit të kompanisë, lindi si një domosdoshmëri për krijimin e rrugës drejt rritjes, përmirësimit dhe suksesit në biznes të çdo punonjësi të "Aga Grup". "Asgjë nuk duhet lënë rastësisë dhe fatit, duam të jetë një proces i ndërgjegjshëm

ku secili kontribuon me dashuri, mençuri, përkushtim dhe vullnet të mirë. Vizioni ynë është që një ditë të bëjmë pjesë në dhjetë kompanitë e para në rajon." Fjala e zotit Vasil Naci si dhe e zotit Artan Koçuku u ndoqën me interes nga të pranishmit si dhe u shoqëruan me pyetje - përgjigje kryesisht mbi konceptet dhe parimet e të jetuarit me vlera, të drejtuarit me zemër, me një komunikim të hapur mbi respektin për bashkëfolësin, të cilat rrisin bashkëpunimin dhe shkëmbimin e lirë të ideve, meritokracinë dhe dallimin në shpërblim në bazë të matjes së performancës, ndarjen e njohurive për t'u rritur profesionalisht, kombinimi i punës me pasion dhe disiplinë që të çon në performancë të shkëlqyer, për një jetë me më shumë kuptim, shpejtësi dhe fleksibilitet në një biznes që rritet vazhdimisht. Në mbjellje të vizitës shefi i grupit të Lidershit, nënkolonel Durim Beu, falënderoi drejtuesit për mikpritjen, si dhe shprehu gatishmërinë për të bashkëpunuar edhe në të ardhmen me këtë institucion pionier të zhvillimit të lidershit.

Msc. Majlinda CUKALLA
Pedagoge për komunikimin dhe didaktikën

Zbatimi i kësaj detyre është një nga objektivat dhe sfidat më të rëndësishme të Forcës Detare për këtë vit

Intensifikohet procesi i standardizimit sipas STANAG/Ap-ve të NATO-s

Një nga objektivat kryesorë të Forcës Detare ka qenë dhe mbetet ratifikimi i STANAG/AP të NATO-s, një proces disavjekar që i shërben standardizimit të kësaj Force në çdo drejtim të veprimtarisë së saj. Si rezultat i punës së kryer nga Komanda, Shtabi dhe Dega e Planifikimit është arritur që deri në dhjetor të vitit të kaluar të ratifikohen 19 STANAG/AP. Por çdo vit kërkesat shtohen dhe bashkë me të metodat, mënyrat dhe afatet për ratifikimin e këtyre detyrave, thotë Kapiteni i Rangut të III-të Diodori Muja, Shefi i Sektorit të Planifikimit, Ndërveprimit e Modernizimit në Degën e planifikimit të FD, ndaj ne kemi përmirësuar programet dhe procedurat për intensifikimin e kësaj pune gjatë këtij viti. Për këtë qëllim më datën 12 mars në Komandën e FD u zhvillua një takim i veçantë me personelin përgjegjës të STANAG/AP, me qëllim njohjen e tyre me procedurat e përgatitjes së raportit të vlerësimit analitik të çdo STANAG-u, urdhrat, detyrat dhe ecurinë sipas afatit. Kap. Lt Blerim Hoxha, specialist për standardet dhe bashkëpunimin në Degën e Planifikimit tregon se këtë vit Forca Detare ka për të përgatitur 10 STANAG/AP, ndaj kemi angazhuar kuadrot më të mirë dhe grupe ekspertësh për çdo individ. Puna ka filluar që në janar dhe në takimin e sotëm çdo person u njoh me temën {STANAG-un} përkatës, me procesin e standardizimit në FD, procedurat e përgatitjes së raport-vlerësimit, mënyra e përgatitjes së brifingut mbi raportin e vlerësimit, afatin kohor për paraqitjen e këtij raporti para bordit të vlerësimit në FD, dhe pastaj në J-5 e Shtabit të Përgjithshëm të FA dhe Qendrën e Doktrinave. Çdo kuadër mbasi njihet me temën përkatëse e studion me imtësi atë në shumë plane, psh sa i shërben rritjes së kapaciteteve operacionale të FD, çfarë mjetesh dhe personeli kërkon, ndryshime strukturore, modernizim, kosto, etj. pra me argumente sjell mundësinë e



zbatimit të tij në FD dhe avantazhet që sjell për Forcat e tjera. Është një punë shkencore, që kërkon përgatitje, eksperiencë, studim, debat, konsulentë, se mbas miratimit nga bordi përkatës në Shtabin e Përgjithshëm deklarohet në strukturat e NATO-s. Dhe atëherë diskutimet bëhen vetëm për modalitetet e zbatimit të këtij apo atij STANAG-u. Pra është një detyrë me përgjegjësi që kërkon seriozitet, njohuri bazë, zotërim të gjuhës angleze dhe bashkëpunim. Në këtë proces ku Forca jonë ballafaqohet me strukturat e NATO-s, sipas urdhrat të komandantit të FD, janë përfshirë 40 kuadrot më të aftë të Forcës Detare, të cilët ne ish-ushtarakët kemi besim dhe i inkurajojmë sinjerisht që ta çojnë më përpara këtë proces. Të arsimuar në shkollat e NATO-s, me një anglishte

prefekte, me eksperiencë të mjaftueshme në anije, kap.lt. Alfred Velaj, Emrush Bejdo, Blendi Melishte, Olsi Avduli, Eralmal Hila, Enkel Lule, Lace Hila, Dritan Laci, Kap. Rangut të III-të Artan Malo dhe toger Vlash Dodaj, janë protagonistët e 10 STANAG/AP që do përgatiten për ratifikim nga Forca Detare për këtë vit. Për mbarëvajtjen e këtij procesi dhe realizimin e raportit të vlerësimit në afatin e caktuar secili nga kuadrot e mësipërm ka dhe një grup ekspertësh, me eksperiencë në këtë fushë, të cilët do ti konsultojnë ata hap pas hapi. Zbatimi i kësaj detyre është një nga objektivat dhe sfidat më të rëndësishme të Forcës Detare për këtë vit, ndaj puna ka filluar me intensitet qysh tani.

Shefqet Kërçelli

Emërohen dhe prezantohen komandantët e reparteve në Brigadën Logjistike

Prezantohen komandantët e reparteve në Brigadën Logjistike. Pas firmosjes së Urdhrave të emërimit nga ministria e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, në garnizonin e Pezë-Helmësit javën e shkuar është bërë prezantimi i katër komandantëve të reparteve të Brigadës Logjistike dhe të shefit të Armatimit të kësaj Brigade. Komandanti i Brigadës Logjistike, gjeneral-brigade Syrja Gjoka ka prezantuar para shtabit të Brigadës Logjistike shefin e armatimit të kësaj brigade, nënkolonel Xhavit Gjoka, të komandantit të "Qendrës së Asgjësimit të Municioneve me Eksploziv", nënkolonel Ajet Dalti, komandantin e batalionit të transportit, nënkolonel Arjan Rroshi, komandantin e batalionit të furnizimit, nënkolonel Eduard Doda si dhe komandantin e batalionit të armatimit, nënkolonel Arian Qirko. Ndërsa në garnizonin e Pezë-Helmësit u prezantimi i tyre para efektivave që drejtojnë. Zëvendëskomandanti i Brigadës Logjistike, kolonel Besnik Sylaj, bëri prezantimin e tyre. Të katër komandantët thanë para efektivit se do të përkushtohen për të kryer me përgjegjësi detyrën dhe për të përbushur të gjitha objektivat e vitit 2014. Nënkolonel Ajet Dalti, i cili drejton QAME, tha se është para një sfide të vështirë dhe duke ecur në traditën e këtij reparti do të çojë më tej të gjitha arritjet: "E di që puna në këtë departament kërkon bashkëpunim në grup që kërkon seriozitet dhe impenjim ndaj do të bëj më të mirën". Edhe komandantët e tjerë konfirmuan se do të keni si orientim kryesor në punën e tyre direktivat e Ministrisë së Mbrojtjes të gjitha detyrat që vijnë nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe do të kërkojnë disiplinë dhe përkushtim tek vartësit e tyre. Të katër komandantët e reparteve kanë marrë detyrat dhe gjatë këtyre ditëve janë njohur me misionin e reparteve që janë emëruar me objektivat e vitit 2014 dhe me dinamikën e punëve që janë kryer në këto dy muaj dhe në muajt në vazhdim. Brigada Logjistike kryen detyra shumë të rëndësishme në drejtim të administrimit të asgjësimit të municioneve të dala jashtë përdorimit, por dhe të ruajtjes dhe mirëmbajtjes së materialeve logjistike të Forcave të Armatosura.

Bashkim Male

DY FJALË PËR LEXUESIN

Dy numra më parë gazeta jonë "Ushtria" botonte një shkrim të Zaim Kuçi (kol (r)), me titull "Për një qasje kombëtare në zhvillimin e Poliitkës së re të Mbrojtjes në fushën e Arsimimit të FA". Për mendimin tim shkrimi ishte mjaft interesant dhe reflektonte ide mjaft racionale në objekt arsimin profesional ushtarak. I rëndësishëm është edhe fakti që ky shkrim vjen në të njëjtën kohë me hedhjen e Direktivës së Ministres së Mbrojtjes për vitin 2014, ku opinioni i autorit vjen origjinal për një numër çështjesh që shtrohen në Direktivë. Personalisht falënderoj autorin dhe stafin e gazetës për hapjen e një rubrike të tillë. Është në vazhden e rubrikës "Academicus", që tentoi të hapej edhe në vitin 2011, por u përveç shkrimit të dr. Simon Gega, nuk patëm shansin të shihnim opinione të tjera për çështjen në fjalë. Pikërisht, në këtë vazhdë është edhe shkrimi që po nis pranë gazetës sonë. Që në hyrje theksoj se pozicionimet e vlerësime të ndryshme gjatë këtij shkrimi janë personale, bazuar në njohuri dhe bindje që kam krijuar nga studimi, analiza dhe eksperiencia personale. Shkrimi që vijon është pjesë e një shkrimi më të gjerë përgatitur për forum akademik. Sjellja në këtë numër po vjen në format të reduktuar dhe me natyrën e vete gazetës. Ai vazhdon me pjesën e dytë: Evolimi 100-vjeçar i modelit të APU në vendin tonë; dhe në pjesën e tretë: "10 modelet më të mira në botë për sistemin e Arsimimit profesional Ushtarak. Mirëpresim komentet e lexuesve.

Kolonel Kristaq Xharo*

(Vijon nga numri i shkuar)

Duke rikujtuar edhe njëherë qëllimin dhe objektin e shkrimit të mësipërm, synimi është thjesht modest "në kërkim të modelit" është një tentativë për të realizuar një vështrim të shkurtër në historinë e arsimit nën moton e asaj që thotë Napoleoni se "... njohja e historisë, e shkaqeve dhe impakteve orienton dhe kontrollon atë ç'ka parashikon të ndodhë...". Tashmë që jemi në start të një reforme të thellë edhe në procesin e arsimimit dhe të trajnimit shikimi drejt modeleve më të mira mund të jetë një mundësi vështrimi dhe përjasje drejt objektivave tanë prioritarë. Në vazhdim, duke mos marrë përsipër të gjejmë përfundime mendoj se mund të jetë efektive ftesa për të debatuar në tematika të tilla si:

- Parashtesë: Historia e FA ka plotësuar shekullin; edhe arsimimi profesional ushtarak po shkon drejt 100 viteve. Kjo histori ka amplitudat e veta. Bashkimi i periudhave më të suksesshme jep optimizëm për standarde bashkëkohore të profesionalizmit të ushtarakëve. Ajo që dallon në këta 100 vjet është aftësia për tu adaptuar e për të synuar vlerat më të mira jo vetëm kombëtare por edhe botërore.

Ftesë për Debat: duke evidentuar në vlerat e historisë, e duke ju referuar kemi të gjitha kapacitetet për të konsoliduar një model që ti përgjigjet kohës dhe sfidave për të ardhmen.

- Parashtesë: Sot në perëndim njihen disa modele të APU. Ato kanë eksperiencën e luftërave dhe karakteristikat e njohjes, parashikimit dhe adaptimit me sfidat e luftërave të ardhshme. Modeli "West Point" padyshim ka provuar të jetë më i suksesshmi. Të famshëm janë edhe modeli gjerman, britanik, austriak, italian etj. Vende të ndryshme të rajonit aplikojnë modele të ndryshme. Në vendin tonë përgjatë 100 viteve janë tentuar të adaptohen disa modele. Për gati 100 vjet të shtetit



shqiptar dhe të Forcave të Armatosura të tij, shumë modele të përgatitjes dhe arsimimit të ushtarakëve janë tentuar të realizohen (austriak, italian, holandez, rus, hibrid, gjerman, amerikan, dhe së fundi i papërcaktuar). Aktualisht formati i APU kërkon të reformohet për tu krahasuar me një nga këto modele.

Ftesë për Debat: Me kaq shumë eksperiencia/modele, suksese dhe dështime a jemi në kohë e a i kemi mundësitë e kapacitetet që të modelojmë sistemin tonë të arsimit profesional të ushtarakëve? A është koha, vullneti dhe kapacitet për të hapur një debat intelektual për të zgjedhur e zgjidhur modelin më të përshtatshëm për vizionin e arsimimit 2020-2025.

- Parashtesë: Gjeopolitika në rajon, si asnjëherë tjetër ka afuar shanse për shqiptarët. Kryeministri i vendit ka hedhur idenë për unifikim të arsimimit në troje shqiptare. Infrastruktura e ambienteve të arsimimit në garnizonin "Skënderbej" është vlerësuar edhe nga ekspertët e huaj si



Foto arkiv

Në kërkim të modelit të arsimimit



Website i njohur Online-College.org, ka realizuar listimin e "Top-10" për akademi / universitete ushtarake, por edhe kolegjeve/ akademive të mbrojtjes. Nga rreth 40 institucione që përmenden në këtë renditje, në tre listime nga agjenci të ndryshme, ato që qëndrojnë në vendet e para të renditjes janë akademitë amerikane, britanike, franceze, gjermane, italiane.

nga më modernet. Prej disa vitesh në institucionet tona të arsimit ushtarak janë afuar studentë nga Kosova dhe Maqedonia. Në një intervistë të saj, Ministria e Mbrojtjes Mimi Kodheli parashtron konceptin se "...shkollimi, hartimi i koncepteve të stërvitjes për këto forca, përpilimi i vetë strukturave të Forcave të Armatosura bazuar në kërkesat dhe nivelet e NATO-s. Apo jo? Mund të jetë sistemi arsimor, ushtarak i tyre, që mund të ndihmohet apo të unifikohet me atë të Shqipërisë. Programet mësimore, programet stërvitore. Shkëmbimi i një gjëje që ka ndodhur më përpara dhe që është shumë i rëndësishëm...."

Ftesë për Debat: A jemi gati t'i përgjigjemi sfidës së kryeministrit Rama dhe ministres Kodheli për të hapur debatin e për të konkretizuar të parët model të njëjtë të APU? Në këtë kontekst a do rezultonte ky angazhim në unifikim kapacitetesh dhe në ulje direkte të koston financiare.

- Parashtesë: Modelet e ar-

simit profesional ushtarak në perëndim edhe pse të ndryshëm kanë ndër tiparin kryesor të përbashkët mënyrën e të vlerësuarit si pjesë e arsimimit civil, ose përcaktuar ndryshe janë të akredituara në Arsimin e Lartë. Njohin Kartën e Bolonjës, transferimin e krediteve e arsimimin në të tria ciklet. Aktualisht arsimimi ynë ushtarak është pjesë e Ligjit të Arsimit të Lartë.

Ftesë për Debat: a janë hapësirat dhe mundësitë, që duke studiuar dhe mbështetur në modelet më të mira në perëndim, edhe institucionet tona të jenë të krahasueshëm e të njihen edhe në nivele të ekuivalentueshme. Çfarë është e nevojshme për këtë standard: struktura, kurrikulat, metodologjia, infrastruktura etj. Cilat mund të jenë hapat e mëtejshëm me qellim që APU të jetë jo vetëm mundësi për të rritur profesionalizmin, por edhe avantazh për pjesëtarët e FA në integrimin e tyre në shoqëri, pas përfundimit të karrierës?!

- Parashtesë: prej disa vitesh jemi pa Akademi Ushtarak. Megjithëse kujtojmë qe ishim vendi i parë në rajon

që ngritëm universitetin ushtarak, sipas modelit të West Point. Tashmë, falë bujarisë së vendeve fqinje, njëkohësisht dhe partnere kadetët tanë (oficerët e rinj) mund të përgatiten pranë tyre. Duket se "argumenti parësor" ka vazhduar të mbetet kostoja financiare. (Ndërkohë që ka fuqishëm analiza të tjera që e rrëzojnë këtë argument). Në analogji historike kanë qenë 3 periudha kur kemi aplikuar të njëjtat metoda të përgatitjes së oficerëve të rinj jashtë vendit: - pas Pavarësisë deri në krijimin e institucioneve tona të arsimit ushtarak, që zgjati gati 12 vjet; - pas Çlirimit deri në krijimin e Akademisë ushtarake 1958 dhe në këtë kohë. Nëse nisemi nga fakti që misioni kryesor i ushtarakut është mbrojtja e vendit, profesioni i ushtarakut kërkon më shumë se çdo profesion tjetër të realizohet në vendin e vet. Edhe betimi solemn e himni kombëtar është tipar dallues i çdo vendi. Çdo vend pasqyron dhe brumos të oficeri i ri (kadeti) vlerat specifike morale, tradicionale, patriotike, civile etj.

“Profesioni juaj është profesion i nderit. Nëse për shumë grupe të tjera profesionesh, nderi është virtyt i lartë dhe i kërkuar, për ushtarakët ai është pjesë e përshkrimit të punës. Nëse mjeshteri të caktuara e kanë nderin një nga ato që kërkohen, për ushtarakët, nderi është vetë profesioni. Është ai kriter dhe ajo forcë që motivon ushtarakët për të shërbyer me sakrificë që nuk njohin asnjë kufi dhe që shpeshherë habitin të gjithë të tjerët për kapërcimin e kufijve...”
(EDI RAMA)

të cilat janë vlera bazë formuese në profesionin e ushtarakut. Historia e vendit të vet është bazë në formimin e çdo ushtaraku.

Ftesë për Debat: Me çfarë sfidash përballen ushtarakët tanë të përgatitur jashtë vendit apo kryesisht në vendet fqinje? A mund të trajtohet në një forum akademik avantazhet dhe disavantazhet në specifikat e përgatitjes së oficerëve të rinj?

Parashtesë: në respekt e mirënjohje të vendeve ku janë përgatitur, oficerët e rinj do të startojnë përballjen angazhimin e vet me efektive në vendin e origjinës, efektiva që mbartin veçori kulturore, shoqërore, morale, patriotike, mjaft specifike dhe mjaft të ndryshme nga vendet ku janë arsimuar. Përfshirë këtu edhe faktin që procesin e stërvitjes me trupa do ta zhvillojë në një ambient krejt të ndryshëm jo vetëm në respekt të relievit, por edhe të infrastrukturës, formave, metodave e taktikave, nga ato për të cilat është mësuar në vendet e tjera, deri

tek rregulloret, kodet etike do të jenë ndryshojnë mjaft nga vendi në vend. Edhe armatimi e metodat e përdorimit të tij ka veçori nga ajo ç’ka ka mësuar në akademitë e vendeve të tjera.

Ftesë për Debat: Cilat do të jenë karakteristikat e përbashkëta të modelit që do të demonstrojnë në efektivat me trupa oficerët e rinj të përgatitur në vende që historikisht e tradicionalisht kanë modele krejt të ndryshme me njëri –tjetrin të arsimimit të oficerëve (Itali, Greqi, Turqi, Gjermani, Austri, SHBA, etj.). Imagjinoni tre oficerë të rinj, komandantë toge, në të njëjtën kompani që demonstrojnë modelin dhe kulturën specifike sipas vendit ku janë arsimuar. Cili mund të jetë modeli i përbashkët që do të unifikojë këtë strukturë ?!

Parashtesë: Ushtarakët (oficerët e rinj) në çdo vend përgatiten në nivel taktik. Ata zhvillojnë programe, metodika dhe një numër kurikulash që ndryshojnë mjaft nga njëri vend në tjetrin. Kurrikulat në këto nivele lidhen edhe me nivelet e teknologjisë e armatimit që gjithashtu ndryshojnë. Po ashtu një numër armësh dhe specialitetesh që organizohen forcat e armatosura të këtyre vendeve, tek ne ndoshta nuk kanë ekzistuar apo nuk vazhdojnë më tej. Ata do të përgatiten në një realitet specifik, dhe që këtu do të jetë vetëm imagjinari e virtual. Ne nuk mund të mbështesim me aviacion luftarak, por as me artileri (tokësore e ajrore). Armatimi ynë jo i gjithi përputhet me atë që ata janë përgatitur në vendet e tjera. Profesionin e ushtarakut has shumë tepër vështirësi se profesionet e tjera kur realizohet në ambiente të tjera. Në këto kushte arsimimi profesional ushtarak dhe akademitë ushtarake, më shumë se çdo profesion tjetër kanë natyrë kombëtare. Ky fakt është i njohur që prej 1822 kur akademitë ushtarake konsiderohen si simbole kombëtare.

Ftesë për Debat: Duke vlerësuar eksperiencën më të mirë të vendeve ku arsimohen oficerët e rinj, si mund të shkojmë drejt modelit unik në kontekstin e formimit profesional ushtarak

Ka edhe mjaft tematika të tjera që ky shkrim nuk mund ti përfshijë. E rëndësishme është të nxitet debati. Kapacitete intelektuale dhe eksperiencë ka mjaftueshëm për ta zhvilluar jo vetëm debatin por edhe aftësinë për

të afruar zgjedhje.

Përmbyllje - vend për optimizëm dhe bazë për reformim për sistemin tonë të Arsimit profesional Usharak:

- Arsिमimi profesional ushtarak është subjekt i Ligjit të Arsimit të Lartë
- Programet e arsimit ushtarak janë të akredituara në të gjitha ciklet e arsimit
- Akademia është e akredituar në format institucional
- Të gjitha kurset e karrierës janë të ekuivalentuara me nivelet respektive të cikleve të arsimit, sipas ligjit
- Programet institucionale plotësojnë kërkesat kryesore të Kartës së Bolonjës dhe janë të formatuara në sistem kreditesh, plotësisht të transferueshme.
- Të paktën deri në vitin 2011, Akademia e Drejtimit në Gjermani njihet ekuivalencën e programeve në institucionet tona arsimore ushtarake
- Institucionet e APU janë pjesë e Konsorciumit të Akademive Ushtarake (pranuar në Sofje në 22-24 mars 2004)
- Kolegji Rajonal për Çështjet e Sigurisë (KLSM) është në listë pritje për tu akredituar nga Komanda e Transformimit të NATO-s (ACT). Synimi është të përfundojë këtë vit.
- Me evoluimin dhe gjithëpërfshirjen e çështjeve të sigurisë, institucionet e APU kanë arritur të sigurojnë afrimin për arsimim e kualifikim në ciklet e dyta dhe të treta të përfaqësuesve nga të gjitha institucionet e sigurisë, por edhe nga shoqëria civile. Për momentin AFA është i vetmi institucion publik që zhvillon programe studimi në ciklin e dytë e të tretë për këtë çështje.
- Hapësirat dhe mundësitë që i janë krijuar faktorit shqiptar në rajon kanë gjetur konfirmim në pjesëmarrje në institucionet tona të arsimit ushtarak nxitur edhe nga programet e kutikulat që afrohen .
- Institucionet tona arsimore kanë eksperiencë të vlefshme në pjesëmarrje në programet e tyre me pjesëtarë nga trojet shqiptare në të tria ciklet dhe në KLSM nga të gjitha vendet e rajonit e më gjerë.

Në institucione tona arsimore përveç një stafi të mirë-kualifikuar kanë lektuar vetëm për periudhën 2008- 2013 mbi 65 lektorë të huaj, kryesisht perëndimorë si dhe të gjithë ambasadorët e vendeve të NATO-s e të tjerë (vetëm në periudhën 2010-2011 lektuan 18 ambasadorë).

Dhe tani, duke e përmblytur këtë trajtesë, rikujtoj faktin që për sa më sipër janë opinione personale mbi çështje të cilat kërkojnë diskutime mjaft më të gjera, veçanërisht në nivel institucional. Direktiva e Ministres së Mbrojtjes është një mundësi për vlerësim objektiv dhe afat-gjatë për një reformim të thellë për t’ju përgjigjur sfidave të ardhme, mbështetur edhe



mbi traditën 100-vjeçare.

Donald Vandergriff, në “Famous successful and unsuccessful army in history” kur analizon modelet e përgatitjes së oficerëve shprehet se “...pas vitit 1871, mjaft ushtri (amerikane e evropiane) u përpoqën që të kopjonin modelin prusian dhe shumë arritën ta implementonin atë në sistem e në organizim, por thuajse të gjithë dështuan të kenë të njëjtin sukses, sepse dështuan në adaptimin e kulturës gjermane në një truall tjetër të ndryshëm.....Dështimi më i madh në kulturë mbetej humbja e imagjinatës. Është shumë e vështirë të mendosh

jashtë kornizave kulturore, institucionale, politike, religjioze – të cilat edhe veç e veç, por edhe në grup dhe për gjithsecilin na kthejnë pas..”

Modeli i Arsimit Profesional Usharak (APU) do të duhet t’ju përgjigjet ndryshimeve aktuale dhe atyre në vazhdim në periudhën e eksplodimit të informacionit dhe teknologjisë, tipareve të reja të konfliktëve, por edhe vështirësive financiare, ndryshimeve në mjedisin e ri të sigurisë. Në mënyrë të pandërprerë, vizioni i arsimit profesional ushtarak do të duhet të ketë tërësisht një pamje të re, ndjenjë dhe përgjegjësi. Më e rëndësishmja, APU duhet sa më shpejt të fillojë ndryshimet me qellim që të sigurojë e menaxhojë kapacitetet dhe

vazhdueshmërinë që të ndikojë në përgatitjen dhe gatishmërinë e ushtarakëve për sfidat e ardhme dhe të garantojë aftësinë e tyre për kontribuar në sigurinë kombëtare. Ky është dhe fokusi i këtij shkrimi që nëpërmjet një qasje retrospektive të vlerësojmë impaktet gjatë realizimit të Direktivës së Ministres së Mbrojtjes, në çështje që lidhen me pozicionin dhe rolin aktual dhe perspektivë të APU për kapacitete e Forcave tona të Armatosura.

* Prof. Dr. Autori mban titullin shkencor Profesor Doktor dhe është Shefi departamentit të Lidershit në AFA.

NJOFTIM

**MINISTRIA E MBROJTJES
DREJTORIA E ARSIMIMIT DHE PËRKUJDESJES
SOCIALE TË USHTARAKËVE**

Për rikërkim kandidataturash për kurset e ofruara nëpërmjet programit IMET, në SH.B.A dhe Qendrën Marshall.

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Ministrisë së Mbrojtjes i është ofruar pjesëmarrja në kurse institucionale dhe funksionale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Qendrën Marshall, sipas periudhave të cilësuar në listën bashkëlidhur ANEKS A “Lista e kurseve të ofruara nëpërmjet programit CETPM/IMET”, për vitin fiskal 2014. Rikërkimi i kandidataturave bëhet për arsye të mungesës së kandidataturave për disa nga kurset e ofruara nuk ka kandidatura të mundshme, si dhe lista e kurseve është përditësuar, duke ofruar kurse të tjera shtesë. Të gjitha propozimet të shoqërohen me dokumentacion përkatës (CV, përshkrim pune, formular me të dhënat personale në gjuhën angleze dhe fotokopje e pasaportës). Në CV të shtohet edhe një rubrikë ku të pasqyrohet shuma e pikëve të vlerësimit vjetor të çdo kandidati të propozuar. Për kurset e ofruara, lutemi nga ana Juaj të mbani në konsideratë kriteret e kurseve, përshkrimet e kurseve dhe afatet e përcaktuara në listën bashkëlidhur ANEKS A “Lista e kurseve të ofruara nëpërmjet programit CETPM/IMET”, për vitin fiskal 2014. Për informacion dhe paqartësi, lutemi të kontaktoni pikën e kontaktit në DAPSU, Major Tahir Çuka, Tel 510 16 14, e-mail: cukat@mod.gov.al .

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.

DREJTORI, KUJTIM KADZADEJ

Lista e kurseve të ofruara nëpërmjet programit CETPM/IMET, për vitin fiskal 2014.

ANEKS A

Nr.	Periudha	Titulli i Kursit	Kuotat	Kriteret	Përshkrimi i Kursit	Afati
1	09-Korrik-13-Nentor 2014	MIL INTEL BOLC/Kursi Bazë i Zbulimit Ushtarak	1 kuota	Niveli i gjuhës → anglisht 70 pikë; Grada → N/toger- Toger; Të tjera → Certifikatë sigurie niveli “B”.	Përshkrimi: Kursi ofron njohuri dhe aftësi bazë, të gjithë informacionin që i nevojitet një oficeri zbulimi në nivel taktik, si dhe njohurit dhe aftësitë që zotëron një oficer zbulimi në rolin e komandantit të togës . Kurrikula e kursit përfshin tema si: kërcënime të kundërshtrimit, menaxhim i programit të stërvitjes së njësisë, sulmet elektronike, shërbimi inteligjent njerëzor, shërbimi inteligjent i ndërlidhjes, shërbimi inteligjent imazherik, mbështetja në operacioneve, kundërzbulim dhe shërbimi inteligjent në nivel taktik duke përdorur të gjitha burimet në dispozicion.	Jo me vone se 13 Mars 2014
2	14-Shtator-19-Shtator-2014	Seminar me Titullarë “Senior Executive Seminar (SES)”	3 kuota	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë; Grada →Gjeneral Brigade e lart / Civil ekuivalent	Përshkrimi: Ky seminar i organizuar nga Qendra Marshall paraqitet si një forum i cili është i dizenuar për të përgatitur pjesëmarrësit e tij, në rang diplomatësh, parlamentarësh, oficerësh madhorë dhe zyrtarë të lartë publikë, në angazhimin e tyre me çështje delikate të sigurisë globale.	Jo me vone se 14 Maj 2014
3	15-Shtator-2014-26-Janar-2015	QM BASIC OFF LEADER CRS/Kursi bazë i shërbimeve në shtab	1 kuota	Niveli i gjuhës → anglisht 75 pikë; Grada → e papërcaktuar, rekomandohet N/toger-Toger; Të tjera → Kandidatë e propozuar duhet të jenë të aftë fizikisht për përballimin e ngarkesave fizike;	Përshkrimi: Kursi është dizenuar për tu ofruar oficerëve të rinj aftësi në menaxhimin e detyrave në njësi, aftësi operacionale logjistike, aftësi drejtuese, aftësi procedurale në mbështetjen me furnizime, aftësi në menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve fushore. Kursi është i ndërthurur me zhvillimin e stërvitjeve fushore dhe stërvitjeve për menaxhimin e situatave të kontaminimit kimik dhe nuklear.	Jo me vone se 15 Maj 2014
4	26 Shtator 2014 -15 Dhjetor 2014	Programi i Studimeve të Aplikuar të Sigurisë/ Program in Applied Security Studies (PASS)	1 kuota	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë; Grada →Toger – Major / Civil ekuivalent	Përshkrimi: Programi siguron edukim të nivelit të lartë në çështjet e politikës së sigurisë, të mbrojtjes, marrëdhënieve ndërkombëtare, ligjit ndërkombëtar, luftës kundër kimit, korrupsionit dhe trafikimit njerëzor dhe të drogës.	Jo me vone se 26 Maj 2014
5	29-Tetor-2014-24-Nentor-2015	CGSC/Kolegji i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm	1 kuota	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë; Grada →Kapiten-Major Përparesi kanë kandidatet me gradë major. Të kenë kryer detyra komanduesenë nivel kompanie. Të ketë përfunduar Kursin Themelor të Oficerit të Shtabit, në Akademinë e Mbrojtjes ose një kurs ekuivalent i ashtu shtetit	Përshkrimi: Studimet do të përfshijnë pjesën bazë kursin mbi operacionet e avancuara luftarake si dhe lëndët me zgjedhje. Studentët do të marrin informacion mbi: aktorët që veprojnë në një ambient të caktuar dhe bashkëpunimin midis tyre, kuptimin dhe analizimin e koncepteve doktrinale e problemeve ushtarake në nivel strategjik e operacional. Konceptet dhe parimet që aplikohen te njësitë taktike në të gjithë spektrin e kryerjes së operacionit.	Jo me vone se 14 Maj 2014

Sekretari i Përgjithshëm siguron Kryeministrin e Ukrainës se NATO përkrah Ukrainën

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, i tha kryeministrin të Ukrainës, Arsenii Yatseniuk, gjatë takimit të tyre së datës 6 mars se “në këto momente të vështira, NATO përkrah Ukrainën. NATO përkrah të drejtën e çdo kombi për të vendosur rreth të ardhmes së tij. NATO përkrah sovranitetin dhe integritimin territorial të Ukrainës si dhe parimet themelore të së drejtës kombëtare”.

Sekretari i Përgjithshëm dhe kryeministri diskutuan ngjarjet e rënda në Ukrainë dhe se si NATO dhe Ukraina mund të forcojnë partneritetin e tyre. Sekretari i Përgjithshëm tha se kriza në Ukrainë “paraqet pasoja serioze për sigurinë dhe stabilitetin në gjithë zonën euroatlantike”. Ai shtoi se kriza është kërcënimi më serioz për sigurinë e Europës që nga fundi i Luftës së Ftohtë. Rasmussen theksoi se Aleanca synon të rrisë bashkëpunimin e partneritetit nëpërmjet Komisionit NATO-Ukrainë për të mbështetur reformat demokratike. Kjo

do të përfshijë forcimin e lidhjeve me udhëheqjen politike dhe ushtarake të Ukrainës, forcimin e përpjekjeve për ndërtimin e kapaciteteve ushtarake të Ukrainës dhe më shumë trajnime dhe stërvitje të përbashkëta. NATO gjithashtu do të bëjë më tepër për të përfshirë Ukrainën në projektet e saj shumëkombëshe për të zhvilluar aftësitë. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s përgëzoi popullin e Ukrainës për vendosmërinë dhe guximin e tyre si dhe për vetëpërbajtjen e treguar nga Forcat e Armatosura të Ukrainës duke përsëritur se një zgjidhje politike është e vetmja mënyrë për të dalë nga kriza. “Mbi të gjitha, ne i bëjmë thirrje Rusisë të respektojë angazhimet e veta ndërkombëtare dhe të ndalojë përshkallëzimin ushtarak në Krime. Ne i bëjmë thirrje Rusisë që të tërheqë forcat e saj në bazë dhe t’i shmanget ndërhyrjeve të tjera në Ukrainë. S’duhet të ketë përpjekje për të vizatuar kufij të rinj në hartën e Europës në shekullin e 21-të”, përfundoi duke thënë Rasmussen.



Konferenca Ministrore e Romës mbi Libinë . NATO riafirmon angazhimin për të ndihmuar Libinë

Vershbow: Çdo ndihmë e NATO-s në Libi do të përshtatet me atë që me të vërtetë ka nevojë Libia

Më 6 mars, u zhvillua në Romë konferenca ministrore mbi Libinë. Në këtë konferencë, u diskutua koordinimi i përpjekjeve ndërkombëtare për të ndihmuar Libinë dhe morën pjesë ministrat e jashtëm, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe një delegacion i nivelit të lartë nga Libia i kryesuar nga kryeministri Ali Zeidan. Aleatët ranë dakord tetorin e kaluar për t’ju përgjigjur pozitivisht një kërkesë të bërë nga kryeministri i Libisë që NATO të mundësojë këshilla për ndërtimin e institucioneve të mbrojtjes në Libi, si pjesë e përpjekjeve të përgjithshme së bashkësisë ndërkombëtare. Aktualisht, një ekip i vogël këshillimor është vënë në lëvizje për të drejtuar këtë përpjekje. Tre vite më parë, NATO përbushoi një mandat historik për të mbrojtur popullin e Libisë. Ai e bëri këtë përmes operacionit “Mbrojtësi i Unifikuar”. Operacioni u drejtua në bazë të një rezolute së Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara. Gjatë konferencës në Romë, zëvendëssekretari i Përgjithshëm u takua me kryeministrin e Libisë dhe zhvilloi bisedime me përfaqësues të lartë nga NATO, nga vendet e Lindjes së Mesme dhe nga organizata të tjera ndërkombëtare.

Gjatë fjalës së tij në këtë konferencë, zëvendëssekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Alexander Vershbow, u shpreh: “Jam shumë i nderuar që përfaqësoj NATO-n sot këtu dhe dua të filloj duke vlerësuar ministrin e Jashtëm Mogherini dhe Qeverinë Italiane që na dhanë mundësinë të marrim pjesë. Ka arsye të mira që NATO të përfshihet ngushtë në punën tuaj të vazhdueshme.

Ne jemi krenarë për rolin që kemi luajtur tre vjet më parë në përbushjen e një mandati historik të Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara për të mbrojtur popullin e Libisë. Ne jemi të etur për të ndihmuar Libinë që të lëviz drejt një të ardhmeje paqësore, të sigurt dhe demokratike si dhe kemi njohuri dhe ekspertizë të rëndësishme që mund ta ndihmojë atë dhe popullin e saj në këtë udhë. Udhëtimi nga diktatura në liri dhe demokraci është i gjatë dhe i vështirë. Libia ka bërë tashmë një udhë të gjatë, por ka ende shumë për të bërë, para së gjithash, nga vetë populli i Libisë dhe veçanërisht nga udhëheqësit e tyre politikë, por NATO qëndron e gatshme të ndihmojë, në zona ku Qeveria e



Çdo ndihmë e NATO-s në Libi do të zhvillohet jo vetëm me kujdes në lidhje me atë që kombet e organizatat e tjera po ofrojnë, por gjithashtu do të përshtatet me kujdes lidhur me atë që me të vërtetë ka nevojë Libia.

Libisë ka nevojë për ndihmën tonë dhe ku ne mund të shtojmë vlera. NATO ka qenë e shpejtë për t’ju përgjigjur kërkesës së kryeministrin Zeidan për këshilla në ndërtimin e institucioneve të mbrojtjes. Ne kemi krijuar një ekip këshillues për të punuar së bashku me autoritetet libiane në këtë përpjekje dhe ndërsa ne kemi ende disa detaje për të përpunuar para se specialistët tanë të udhëtojnë drejt Libisë, kemi ftuar ekspertët libianë në selinë tonë në Bruksel, ose në një vend të tretë për të vazhduar punën tonë konkrete.

Objekti ynë i parë do të ishte këshillimi i autoriteteve libiane për ngritjen e strukturave të nevojshme, proceseve dhe marrëveshjeve që u

mundësojnë atyre zhvillimin e një strategjie të sigurisë kombëtare. Pasi të nisë kjo punë, ne mund të japim gjithashtu këshilla për përshtatjen e arkitekturës ekzistuese libiane për të siguruar që është në përputhje me kuadrin e ri të politikës. Misioni këshillues i NATO-s nuk do të kërkojë të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës në terrenin e Libisë. Ne do të vazhdojmë të kryejmë punën tonë si këshillues në koordinim të plotë me përpjekjet e pjesëmarrësve të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, duke përfshirë Misionin Mbështetës së Kombeve të Bashkuara në Libi (UNSMIL) dhe Misionin e Asistencës Kufitare të Europës (EUBAM).

Më lejoni gjithashtu të theksoj

Vershbow diskuton partneritetin me ligjvënësit e Moldavisë

Zëvendëssekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Alexander Vershbow, diskutoi avantazhet e bashkëpunimit dhe partneritetit si dhe krizën në Ukrainë me një delegacion të ligjvënësve të Moldavisë më 11 mars 2014. “Ne duam të kërkojmë mënyra për të forcuar përpjekjet tuaja në rrugën e reformave”, tha për parlamentarët zëvendëssekretari i Përgjithshëm.

Moldavia është një partner i vlefshëm për NATO-n, tha Alexander Vershbow. Ai falënderoi delegacionin parlamentar të përbërë prej shtatë anëtarësh për angazhimin e vendit të tyre për të rritur dialogun politik dhe bashkëpunimin me Aleancën. Ambasadori Vershbow gjithashtu falënderoi Moldavinë për vendimin e saj të fundit për të kontribuar me trupa në misionin e Aleancës në Kosovë. Një kontingjent prej 41 ushtarësh u bashkua me operacionin e KFOR-it më datë 8 mars. Kjo është hera e parë që Moldavia merr pjesë në një mision të NATO-s.

Ai gjithashtu përgëzoi vendimin e Moldavisë për t’u afruar Bashkimit Europian me siglirin e një Marrëveshjeje Asocimi. Ambasadori tha se integrimi evropian është në përputhje me marrëdhëniet më të ngushta me NATO-n. Gjatë takimit, zëvendëssekretari i Përgjithshëm përsëriti respektin e NATO-s ndaj neutralitetit kushtetues të Moldavisë dhe theksoi se aleatët vazhdojnë të mbështesin pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të vendit. Delegacioni i Moldavisë kryesohet nga z. Alexandru Cimbriciuc, zëvendëskryetari i Komisionit të Sigurisë Kombëtare, Mbrojtjes dhe Rendit Publik dhe kreu i delegacionit të Moldavisë në Asambleenë Parlamentare të NATO-s.



ekspertizën e veçantë të NATO-s me reformën e mbrojtjes dhe ndërtimin e institucioneve të sigurisë. Kjo përfshin këshilla mbi zhvillimin e strukturave efikase të mbrojtjes që janë nën mbikëqyrje civile dhe kontroll demokratik. Ky është lloji i këshillave që kemi në dispozicion në këtë moment në vende si Kosova, Iraku dhe Afganistani. Gjithashtu, kemi luajtur një rol të madh 20 vitet e fundit në reformën e sektorit të mbrojtjes në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore në kuadër të Partneritetit për Paqe. Përvoja e NATO-s në ndarjen e kësaj ekspertize na ka mësuar se çdo vend është ndryshe dhe se nuk ka qasje që mund t’i përshtatet të gjithëve. Pra, çdo ndihmë e NATO-s në Libi do

të zhvillohet jo vetëm me kujdes në lidhje me atë që kombet e organizatat e tjera po ofrojnë, por gjithashtu do të përshtatet me kujdes lidhur me atë që me të vërtetë ka nevojë Libia.

Kjo më sjell te një kërkesë përfundimtare për suksesin e përpjekjeve tona, që është pronësia e fortë e Libisë. Ne jemi impresionuar nga progresi që ka bërë Libia gjatë këtyre viteve të fundit. Ne jemi të sigurt se kjo do të tregojë vendosmërinë për të lejuar komunitetin ndërkombëtar të vijë në ndihmë të saj. NATO është e gatshme të ndihmojë. Shpresojmë që kjo konferencë të na bashkojë për të mirën e popullit libian”.

Alba Musaraj

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ
HISTORIAN USHTARAK

Me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë Nacionalçlirimtare, më 17 mars 1944, në Vlush të Skraparit u formua Brigada e VII Sulmuese (Br. VII S). Në rreshtat e brigadës u rreshtuan partizanë me eksperiencë në luftë të batalioneve të qarkut të Beratit, të Grupit të Skraparit, të batalionit të rinisë "Margarita Tutulani" etj. Erdhën gjithashtu dhe mjaft partizanë nga qarku i Gjirokastrës dhe nga qarku i Korçës. Në komandë të brigadës u emëruan: komandant Gjini Marku dhe pas Musa Daci; komisar Kadri Hoxha dhe më vonë oficer karriere, Qazim Kapisyzi. Kuadro dhe luftëtarë të Br. VII S ishin dhe Adil Çarçani, zëvendës-komisar, Ramiz Alia përgjegjës i rinisë i brigadës, etj. Situata në të cilën u krijua Br. VII S ishte shumë më e favorshme nga ato në të cilat u krijuan Br. V-VI S. Operacioni armik i Dimrit kishte marrë fund. Armiku ishte kthyer në bazat e veta, në qytete e garnizone dhe po rigjeneronte forcat e mjetet. Humbjet që u shkaktuan nga mësymja e përgjithshme armike në dimrin 1943-1944, dhe rreziku më i madh për forcat partizane ishte të mos binte fryma luftarake sulmuese e reparteve dhe njësisve partizane dhe të krijohej kështu ndjenja për një pushim, për një çlodhje pas operacionit. Shtabi i Përgjithshëm e mënjanoi një rrezik të tillë duke kërkuar nga Ushtria Nacionalçlirimtare të hidhej papritur në kundërmësymje. Dhjetë ditë pas inaugurimit, më 27 mars, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm, brigada ndërmoi një sulm kundër garnizonit gjerman të instaluar në qytetin e Beratit. Lufta brenda në qytet vazhdoi deri në 5 orë. Në këtë provë të parë të brigadës, partizanët dhe drejtuesit e saj, të kalitur në beteja dhe luftëra, treguan zotësi, trimëri dhe mjeshtëri në taktikën e luftës partizane, sidomos në qytet. Kundërmësymja e reparteve të UNÇSH e zhvilluar me sukses në janar-shkurtmars 1944, solli si përfundim çlirimin e të gjitha krahinave të pushtuara gjatë operacionit armik në Shqipërinë e Jugut. Pas sulmit në garnizonin e Beratit, nazistët gjermanë me forca të mëdha u hodhën kundër vendstrehimeve të brigadës, në krahinat e Nahijes dhe të Shpiragut. Në këtë luftë që vazhdoi deri në 7 ditë, forcat e brigadës përballuan presionin e armikut, e rraskapitën atë dhe e detyruan të tërhiqej duke i shkaktuar të vranë dhe të plagosur e mjaft dëme materiale. Pas këtyre sulmeve brigada mori iniciativën dhe kreu një varg goditjesh kundër armikut në qytetin e Beratit, të Kuçovës dhe në krahinën e Myzeqesë. Në kohën kur do të zhvillonte punimet Kongresi i Përmetit, Br. VII S ju ngarkua detyra të ruante zonën e Përmetit nga ana e Beratit. Në këto kushte e gjeti operacioni i Qershorit 1944. Forca të shumta naziste gjermane, duke pasur përpara dhe forca reaksionare të vendit, filluan operacionin në rajonin ku vepron brigada. Në këtë rajon ajo bashkëveproi me forcat e Br. XII S dhe me ato të shtabit të qarkut të Beratit. Me gjithë presionin e madh të ushtruan ndaj saj, armiku nuk mund të çante rrugën për në Këlcyrë. Nazistët dhe bashkëpunëtorët e tyre u thyen keq në Qafë të Shkozës, në Therapel, në Paraspuar etj. Ata pësuan mjaft humbje të mëdha, të vranë dhe të plagosur, si dhe dëme të shumta materiale. Pas këtyre përleshjeve forcat e Br. VII S mbrojtën me këmbëngulje vijën Vëndrezh-Tendë e Qypit, për të ndaluar forcat armike të qarkut të Korçës, të cilat u orvatën të goditnin në shpinë qytetin e Përmetit. Pas këtyre operacioneve brigada mori përsëri iniciativën, preu komunikacionet, sulmoi Beratit, Kuçovën, Fierin, Lushnjën dhe zhduku vatrat e reaksionit në krahinën e Myzeqesë. Në këto aksione është për t'u vlerësuar puna e madhe sqaruese e partizanëve me popullin e Myzeqesë, për luftë kundër pushtuesit dhe çlirimin e vendit. Më 7 shtator 1944, brigada filloi mësymjen për çlirimin e qytetit të Beratit, ku armiku ishte i fortifikuar mirë. Pas luftimesh të ashpra, përvojës së fituar në luftën në qytet dhe kundër fortifikatave, forcat partizane të Brigadës VII Sulmuese dhe të qarkut të Beratit, pas një lufte të përgjakshme, më 12 shtator 1944, çliruan qytetin e Beratit. Populli i Beratit feston i gëzuar çlirimin përfundimtar të qytetit. Edhe në krahinat e tjera të Shqipërisë së Mesme e të Veriut, pushtuesit hitlerianë dhe tradhtarët nuk mundën ta shuanin Lëvizjen Nacionalçlirimtare, megjithëse këto krahina qëndruan edhe për një kohë të pushtuara nga armiqët. Aty vepronin

KOMANDANT GJINI MARKU

Ka lindur më 2 qershor 1918, në fshatin Baz, të Mirditës në një familje me emër në atë krahinë. Kur vdes i ati i Gjinit, Pjetër Marku, miku i këtij të fundit, Hysen Selmani, si dhe byrazieri i tij, Abaz Kupi, e marrin Gjini 9-vjeçar dhe e dërgojnë në Tiranë, në "Strehën Vorfënore". Këtu Gjini mori mësimet e para të fillores dhe arsimit 5-vjeçar. Në vitet 1932-1936, Gjini Marku mbaron shkollën e mesme teknike "Harry Fultz" po në Tiranë dhe më vonë në Kavajë (vetëm dy muaj), në degën e Bujqësisë. Pas mbarimit të shkollës emërohet agronom në rrethin e Korçës. Në luftë caktohet komandant i Br. VII S dhe më tej komandant i Div. VI S. Në vitin 1945, pas luftës, Gjini, si shumë drejtues të tjerë të luftës, caktohet për të kryer studimet në fushën ushtarake në Bashkimin Sovjetik. Ai ishte nga të paktët studentë nga Shqipëria që vazhdoi akademinë "Voroshilov" në Moskë. Kjo akademi ishte shkollë që nxirrte specialistë të nivelit më të lartë në fushën ushtarake dhe strategjike në të gjithë botën e asaj kohe. Studimet në këtë akademi Gjini i vazhdoi për tre vjet dhe iu ndërpre e drejta e studimit në vitin e fundit, 1948-1949, për shkak të përplasjeve që pati në Kongresin I të PKSH-së, u dënua për agjitacion-propagandë, në nëntor 1948. Vdes nga ceroza e mëlçisë më 1986.

KOMISAR KADRI HOXHA

Ka lindur në Orenjë të Librazhdit më 15 gusht 1912, në një familje me tradita atdhetare. Babai i tij, Hazis Hoxha ka qenë roja personale i Aqif Pashë Elbasanit në janar 1920, në Kongresin e Lushnjës. Kryen shkollën fillore në Shëngjergj dhe studion në shkollën teknike "Harry Fultz" në Tiranë. Përkthen nga anglishtja Rubairat e Omar Khajamit. Këtu zuri shoqëri me intelektualë si Nonda Bulka, Andrea Varfi, Selim Shpuza etj. Në dhjetor 1941, me formimin e Qarkorit Politik të Elbasanit zgjidhet sekretar politik i këtij qarku. Në vitin 1942, krijohet çeta e Çerme-nikës, ku u zgjodh dhe komandant i saj. Më tej emërohet komisar i Br. VII S. Në shtator 1944 caktohet kryetar i misionit ushtarak i Shtabit të Përgjithshëm pranë Shtabit të Aleancës ushtarake kundër fashizmit në Itali.

Rruga luftarake e Brigadës VII Sulmuese



pa pushim njësitet partizane dhe shumë këshilla nacionalçlirimtare. Nga fundi i shtatorit, Br. VII S u inkuadrua në Div. II S dhe lëvizti për në Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut. Br. VII S mori pjesë në spastrimin e gjithë krahinës së Mirditës. Pas marshimeve të gjatë dhe luftërave me armikun ajo mbërriti në Mirditë, dhe së bashku me forcat e tjera të Divizionit, likuiduan qëndresën e pushtuesve gjermanë dhe të mercenarëve në Gëziq e Shpal. Pas kësaj fitoreje, më 20 nëntor 1944, me një sulm të furishëm ajo hyri në Lezhë dhe pastaj, më 29 nëntor 1944 në Shkodër. Me një urdhër të Komandës së Përgjithshme, brigada u inkuadrua në Div. VI S, dhe mori detyrë për të kaluar në Mal të Zi, për të ndjekur dhe sulmuar nazistët gjermanë e bashkëpunëtorët e tyre që ishin përqendruar në Podgoricë dhe në rrugën Podgoricë-Kalashin. Në detyrën e Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH thuhej: "Të sulmojë e të shkatër-

rojë pikëmbështetjet gjermane në Bloçe, në Tuz dhe të marrë pjesë bashkë me forcat malazeze në çlirimin e Podgoricës. Pas plotësimit të detyrave do të vihet në ndjekje të armiqve drejt Sarajevës". Në luftimet e Malit të Zi brigada tregoi zotësi dhe heroizëm. Në kushte të vështira klimaterike të terrenit dhe të furnizimit, ashtu si gjithë forcat e tjera të divizionit, ajo nuk e la asnjë çast në prehje armikun, por luftoi dhe e ndoqi natë e ditë. Forcat e saj, në bashkëveprim me forcat e Div. VI S, si dhe me reparte të Br. IX Jugosllave dhe çliruan Podgoricën. Gjatë viteve 1942-1945, përtej kufijve shtetërorë të Shqipërisë, në Dibër e në Maqedoni, në Kosovë e Mal të Zi, në Bosnje e Hercegovinë kanë luftuar me heroizëm kundër pushtuesve italo-gjermanë më tepër se 20.000 luftëtarë të UNÇSH për çlirimin e vëllezërve shqiptarë të Kosovës dhe të popujve të Jugosllavisë. Në këto luftime kanë dhënë jetën qindra partizanë shqiptarë. Më pas Br. VII S vazhdoi të ndjekë armikun, me një marshim të vështirë dhe të lavdishëm, nëpër bjeshkët e Sanxhakut të mbuluara me dëborë, duke bërë luftime të përgjakshme në Rudo, dhe veçanërisht në Suhagorë, dhe iu afrua Vishegradit, Edhe këtu partizanët e Br. VII S luftuan me heroizëm, krahas forcave të tjera të divizionit, duke dhënë një kontribut të madh në çlirimin e këtij qyteti. Në fletët e ditarit të Div. VI S, në kronikën e luftimeve të tij thuhet: dita e parë 8 dhjetor 1944, Br. VII S merr pozicionet e Br. VI S në sektorin Kosor-Bioçe dhe vazhdon sulmet. Dita e dytë, 9 dhjetor 1944, Br. VII S ndërmerri sulme mbi pozicionet e armikut në Kosor e në Bioçe. Dita e tretë, 10 dhjetor 1944, Br. VII S vazhdon luftime të pandërprera. Aviacioni aleat intercepton grumbullimin e forcave armike në Bioçe dhe gjatë luginës Moracës dhe lumit Tara. Në komunikatën e Div. VI S më 15 dhjetor 1944 lexojmë: "Luftimet në luginën e lumit Moraça, nga Br. VII S

në veçanti në lokalitetin Bioçe disa ditë rresht bëhen të pandërprera. Heroizmi partizan është i papërskueshëm". Komandanti i Br. VII S, major Musa Daci, për sulmet e natës njoftonte: "Sulmi filloi në orën 18.30, zjarri u ndez në një sektor prej afro dy km gjatësi. Armiku u mundua të qëndronte duke vënë në përdorim të gjerë artilerinë si dhe një numër të madh mortajash. Vendi i luftimit për çdo rast ndriçohej nga raketa me ngjyrë të verdhë, që hidheshin nga armiku. Partizanët, me sulme dhe me zjarr u pykëzuan në formacionet e reparteve gjermane dhe i detyruan ato të thyhen e të tërhiqen. Gjatë luftimit nga gjermanët mbetën të vranë e të plagosur dhe u kapën 53 ushtarë robër. Vazhdon tërë ditën lufta. Me të vërtetë ka qenë një zjarr i rreptë dhe partizanët luftuan me vendosmëri". Ndërsa në ditarin e datës 18 dhjetor 1944 lexojmë: "Ishte një ditë e përflakur, me luftime nga më të ndryshmet, me sulme e kundërsulme që zgjatën gjer në orën 20.00 të mbrëmjes. e këto veprime brigade kapi disa objekte të rëndësishme të armikut". Më tej më 1 janar 1945 "Br. VII S nis e para marshimin në drejtim të Bosnjës. Ajo lëvizti përgjatë luginës së Moraçës, anash lumit, në lokalitetin Bioçe, kalon lumin, vazhdon marshimin në drejtim të Jablanicës. Rruga gjer në Jablanicë me dredha e të përpjeta". Pas çlirimit të qytetit të Vishegradit, Br. VII S u kthye në atdhe, duke kaluar nga Kosova e Maqedonia. Në këto zona ajo zhvilloi me masat popullore një punë sqaruese të madhe. Në luftë kundër pushtuesit fashistë dhe tradhtarëve të vendit nga Br. VII S ranë dëshmorë 160 partizanë e partizane, ndërjet të cilëve Koli Myzeqari, Gani Nivica, Skënder Libohova, Tom Karadaku, Thimi Tani, Mak Dashi, Thoma Shqina, Zyra Xhaxho, Marsh Gjoni, Ferik Lezha, Haxhi Sade, Fari Zaimi, Loni Odriçani, Thimi Tole, Medi Vila, etj. Br. VII S është dekoruar me urdhërin Ylli Partizan i Klasit të Parë.

14 MARS, DITA E VERËS



14 MARS 2014, DITA E VERËS



14 MARS 2014, DITA E VERËS

“Çështë Dita e Verës?
Ësht dita në të cilën
stërgjyshërit tanë, kur
s’kish lindur edhe
krishtërimi, kremtonin
bashkë me romakët dhe
me grekët e vjetër, perën-
ditë e lulevet, të shëlgje-
vet. Kur shkruan dimri,
kur qaset vera buzëqe-
shur, e hollë dhe e gjatë
si në pikturë të Botiçelit,
zemra e njeriut shkarko-
het nga një barrë, shijon
një qetësi, një lumtëri të
ëmbël. Në këtë gëzim,
stërgjyshërit tanë ndi-
enin një detyrë t’u falen
perëndivët që siellin këto
mirësira. Dhe ashtu leu
festa hiroshë që e quejnë
Dita e Verës. Në pak ditë
në Shqipëri, besnikët e
fundmë të paganizmit,
besnikë pa dashur dhe pa
ditur, do të rrethojnë me
verore degët e thanavet,
të dëllinjavet, të dafi-
navet, të gjitha shëlgjevet
të nderuara. Do të këpu-
tin degë të gjelbra dhe do
t’i vënë përmbi kryet e
shtëpivët. Të mos i lëmë
të humbasin këto festa të
vjetra të racës sonë. Nuk i
bëjnë dëm njeriut. Sjellin
një gëzim të kulluar në
shtëpi. Në një vend ku
jeta e të vegjëlvet është
aq e trishtuar, djelmuria
dhe vajzat kanë një rasë
të rrallë për të dëfryer.
Për të mëdhenjtë, Dita e
Verës ka një shije poetike
të hollë e të rrallë”.

(Faik Konica,
“Vepra”, Tiranë,
“Shtëp. bot. Naim Frashëri”
1993, fq. 111).